



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

E Drejtë Publike

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Armela KROMIÇI

Dr. Eda ÇELA

Gusht / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në “E Drejtë Publike”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i së Drejtës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: “E Drejtë Publike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr. 346, datë 17.09.2015.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 6/1, datë 19.05.2017
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 370, datë 23.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 63, datë 05.07.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2022 – 2023 91 studentë; 2023 - 2024 64 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është një institucion jo publik, i hapur me VKM Nr. 177, datë 19.02.2009, “Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit “Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë”, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe është riorganizuar me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr. 273, datë 18. 05. 2017. Me vendimin nr. 62, datë 16. 12. 2020, Bordi i Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) ka vendosur të akreditojë Universitetin “Mesdhetar i Shqipërisë” deri më datë 17.12.2026. Universiteti përbëhet nga katër fakultete:


1. Fakulteti i Shkencave Ekonomike;
2. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane;
3. Fakulteti i Informatikës;
4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;

Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Publike” ofrohet si cikël i dytë i studimeve universitare i ofruar nga Departamenti i së Drejtës pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, i licencuar me urdhër MAS, nr. 346, datë 17.09.2015 dhe i akredituar me VBA Nr. 63, datë 05.07. 2019 (me kohëzgjatje 4 vite dhe afat vlefshmërie deri më 30.09.2023). Me datë 24.02.2023, IAL “Mesdhetar i Shqipërisë” ka dorëzuar në ASCAL, shkresë e IAL, nr. 419 Prot, datë 24.02.2023, formularin e aplikimit, regjistruar në protokollin e ASCAL, nr. 108/2 Prot., datë 24.02.2023 për riakreditim të programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë Publike”. Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemit European të Transferimit të Krediteve në 120 kredite ECTS, ku në përfundim të tij studentët përfitojnë diplomën Master i Shkencave në “E Drejtë Publike”. Programi i studimit në Master i Shkencave “E drejtë Publike” është i hartuar dhe zbatohet nga Departamenti i së Drejtës, duke harmonizuar të gjithë komponentët e tij në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimet dhe misionin e Institucionit dhe Departamentit. Qëllimi i këtij programi studimi është të formojë specialistë cilësorë të së drejtës publike të aftë për t’iu përgjigjur nevojave të zhvillimit të administratës së brendshme dhe sfidave që vijnë për shkak të Shqipërisë si vend kandidat për t’u anëtarësuar në BE dhe zhvillimeve aktuale globale.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr. 109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupin e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Publike” me anëtarë: Dr. Armela Kromiçi dhe Dr. Eda Çela. Grupi i vlerësimit të jashtëm është trajnuar dhe asistuar nga koordinatorja dhe përfaqësuesja e ASCAL, Znj. Majlinda Demireli. GVJ falë asistencës së përfaqësues së ASCAL, iu mundësoi akses online dhe pati mundësi të njihej fillimisht me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të hartuar nga vetë institucioni në proces akreditimi, që shërbeu si pikënisje për të patur një vizion të qartë të detyrave të këtij grupi pune dhe për zhvillimin e takimeve në institucion. Me datë 12.02.2024, GVJ gjatë vizitës në institucion realizoi një sërë takimesh me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Drejtuesin e Departamentin e së Drejtës Publike dhe Koordinatorin e Masterit Shkencor “E Drejtë Publike”, stafin akademik dhe studentët e këtij masteri, NJSBC, zyrën e këshillimit të karrierës, zyrën e burimeve njerëzore, zyrën e marrëdhënieve me jashtë, Erasmus+ dhe të projekteve, sekretarinë mësimore dhe bibliotekën. Gjatë këtyre takimeve GVJ u asistua nga përfaqësuesja e institucionit. Këto takime u shoqëruan me diskutime dhe në përfundim të tyre GVJ kërkoi dokumentacion shtesë për të plotësuar dhe përditësuar informacionin e përmbajtur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm. Kjo kërkesë u përmbush nga Institucioni dhe dokumentacioni i kërkuar mund të aksesohet online në sistemin e ASCAL. Për realizimin e vlerësimit së përmbushjes së kriterëve për riakreditimin periodik të programit të Master i Shkencave “E Drejtë Publike, GVJ u mbështet kryesisht në kriteret e përcaktuara tek Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në dokumentacionin e përmbajtur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin shtesë dhe në informacionin e përfituar nga takimet e drejtëpërdrejta me grupet e interesit. Të gjithë këta element ndihmuan në hartimin e raportit të mëposhtëm, i cili paraqet vlerësimin e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 31.05.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 2/16 Prot, datë 31.05.2024. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” përcjell në ASCAL më datë 02.07.2024 nëpërmjet shkresës me nr.722/1 Prot, datë 24.06.2024 “Objeksione për draft raportin e vlerësimit të jashtëm”. *Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*



1. Për Objeksion / Sqarim të UMSH-së, referuar plotësimit të rekomandimeve të lëna nga akreditimi paraardhës, dhe konkluzionet e standartit II.1

GVJ në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 ka evidentuar pikat ku institucioni duhet të orientojë vëmendjen e tij dhe pikat ku institucioni duhet të ndërhyjë për të përmirësuar programin e studimit në Master i Shkencave në "E Drejtë Publike". Në këtë kontekst, përkthimi në anglisht i syllabuseve dhe pajisja me kod e lëndëve, sillen në vëmendje të institucionit për t'u mbajtur në konsideratë, e para lehtësisht e realizueshme dhe e dyta në bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit. Por këto dy element nuk kanë ndikuar në hartimin e draft-raportit dhe vlerësimin përfundimtar të këtij programi. Ndërkohë, GVJ vlerëson që Institucioni duhet të rishikojë me kujdes të veçantë kurrikulën e ofruar në programin Master i Shkencave në "E Drejtë Publike", ku syllabuset e këtij programi të jenë në përputhje me qëllimin e përndjekur prej tij. GVJ nuk konteston përmbushjen e kriterëve formale por rekomandon institucionin të rishikojë në përmbajtje kurrikulën e ofruar në këtë master shkencor. Sikurse është sqaruar dhe në draft-raport GVJ rekomandon të nevojshme rishikimin e lëndëve me qëllim dallimin në mënyrë të përshtatshme të lëndëve që zhvillohen me ciklin e mëparshëm të studimit dhe thellimit të tyre në këtë cikël studimi. Kështu, duke referuar tek vetë lëndët e cituara në f. 5 të objeksioneve për draft-raportin, E drejta penale tregtare dhe e drejta penale ndërkombëtare janë lëndë të profilizuara por me drejtim civil dhe penal. Ndërsa, E drejta administrative e thelluar dhe teknika legislative e thelluar ndonëse lëndë të një profili publik, bazuar tek syllabusi i depozituar, janë lëndë që në pjesën më të madhe të tyre duhet të jenë të ezaurura në ciklin e mëparshëm të studimit. Çfarë risije sjell studimi i këtyre lëndëve në këtë cikël studimi nga ai i mëparshmi. Në lidhje me nevojën e përditësimit bashkëkohor të literaturës, sikurse evidentohet në draft-raport GVJ vlerëson faktin që institucioni mbështet dhe financon, bazuar në procedurë të qartë dhe standarde, botimet e stafit të tij akademik. Nga ana tjetër përditësimi i literaturës nuk përkthehet domosdoshmërisht në kërkim të botimeve të teksteve mësimore nga stafi akademik. Përditësimi i literaturës bëhet edhe duke referuar tek botimet e autorëve të tjerë vendas dhe të huaj, artikuj shkencor, referate por dhe duke përfshirë në syllabuse praktikën gjyqësore vendase dhe atë të huaj, të viteve të fundit. GVJ është e bindur që stafi akademik i angazhuar në këtë master e përmbush këtë detyrimin në auditore, por kjo duhet të jetë e pasqyruar qartë dhe në syllabuset e lëndëve të përmbajtuara në planin mësimor. Në këtë kontekst vjen dhe rekomandimi i GVJ-së për nevojën e rishikimit dhe të përditësimit të programit mësimor të masterit shkencor "E Drejtë Publike". GVJ-ja rekomandon orientimin e lëndëve të këtij programi drejt lëndëve ndërdisiplinare apo me zgjedhje me fokusin parësor në të drejtë publike, duke ndjekur praktikat më të mira të vendeve të tjera me eksperiencë më të gjatë në këtë drejtim për ta bërë këtë master sa më tërheqës dhe diferencues. Për të gjitha më sipër, GVJ i qëndron sqarimeve dhe detajimeve të bëra në draft-raport, **raporti nuk ndryshon.**

2. Për Objeksion/Sqarim të UMSH-së, lidhur me standartin I.3. kriteret 1 dhe 2,

GVJ i qëndron mendimit se institucioni duhet të intensifikojë nënshkrimin e marrëveshjeve institucionale dhe të punojë për zbatimin efektiv të këtyre marrëveshjeve. Gjithashtu ritheksohet nevoja për të rritur bashkëpunimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me insitucione të tjera si motra me qëllim rritjen e shkëmbimit të stafit akademik dhe të studentëve. Duke mbajtur në konsideratë dhe organet e reja të krijuara me reformën në drejtësi fton insitucionin të rrisë nagazhimin e tij në rritjen e bashkëpunimit me këto insitucione. Gjithashtu i qëndrojmë mendimit që Departamenti i së Drejtës dhe koordinatori i programit të studimit, të hartojnë një model raporti analitik vjetor ku të pasqyrohen qartë mobilitetet, trajnimet, mbështetja financiare për stafin akademik dhe studentët e masterit në “E Drejtë Publike”. **Raporti në këto pika nuk ndryshon.**

3. **Për Objeksion/Sqarim të UMSH-së, lidhur me standartin II.1. kriteri 3,** GVJ i qëndron mendimit të shprehur në raport, duke vlerësuar se në këtë raport mund ndër të tjera të pasqyrohet angazhimi i stafit akademik në programet e tjera të ofruara nga ky institucion dhe angazhimi efektiv në programin e studimit problematikat dhe vështirësitë që ky staf has në përmbushjen e detyrave të tij, ngarkesën mësimore dhe kohë që i dedikohet kërkimit shkencor që ndikon jo vetëm në rritjen e tyre akademike por dhe në performancë. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
4. **Për Objeksion/Sqarim të UMSH-së, lidhur me standartin II.2. kriteri 1,** bazuar tek rekomandimet e lëna nga akreditimi i mëparshëm dhe tek evidencat e depozituara nga vetë institucioni, GVJ sjell në vëmendje të insitucionet nevojën për të ndihmuar dhe promovuar rritjen profesionale të stafit akademik të angazhuar në masterin e shkencave “E drejtë publike” me gradat dhe titujt e nevojshëm. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
5. **Për Objeksion/Sqarim të UMSH-së, lidhur me standartin II.4. kriteret 1, 2 dhe 4,** GVJ i qëndron mendimit të shprehur në raport, duke rekomanduar që në rregullore të përcaktohen edhe afate të qarta përsa i përket afatit deri kur studenti mund të ankohet mbasi ka marrë dijeni për notën dhe afatet referuese për verifikimin e situatës pasi kjo do të ndikojë në sigurinë juridike të vlerësimit përfundimtar. Në hartimin e këtij rekomandimi GVJ është referuar pikërisht tek neni 23 i Rregullores së programit të Studimit Msc në “E drejtë Publike”. Është e vërtetë që studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të provimit dhe notës brenda 2 ditëve nga dhënia e provimit por më pas mungojnë afatet dhe modalitetet sesi studenti i drejtohet Dekanit, në rast se ezaurimi i procesit të ankimit me pedagogun e lëndës nuk ka qenë efektiv, dhe në sa kohë dhe në ç’mënyrë Dekani me miratimin e Rektorit dhe së bashku me Koordinatorin e programit të masterit, përgjegjësin e departamentit dhe komisionin përkatës të provimit verifikojnë shkeljet dhe vendosin ribërjen e provimit. Në këtë pikë GVJ do të rekomandonte thjeshtim të procedurës dhe sikurse përmendet më lart dhe në draft-raportin vendosjen e afateve të shkurtra dhe procedurave standarde të qarta. **Raporti në këto pika nuk ndryshon.**
6. **Për Objeksion/Sqarim të UMSH-së, lidhur me standartin II.5. kriteri 1,** GVJ, rekomandon që në rregullore e këtij masteri të parashikohen dhe të rregullohen qartë modalitetet dhe procedurat

e zhvillimit të praktika profesionale dhe klinika e ligjit si dhe mënyra e rekrutimit të studentëve për tu bërë pjesë e saj. GVJ, nuk konteston rregullimin e klinikës ligjore në aktet normative të institucionit por rekomandon që klinika e ligjit, të rregullohet në mënyrë më specifike dhe në rregulloren e masterin shkencor “E drejtë publike” dhe të zbatohet gjerësisht dhe për këta student. Nga takimet e GVJ me studentët dhe nisur nga fakti që është një lëndë e rëndësishme për formimin profesional të studentëve, GVJ rekomandon që kësaj lëndë t’i njihet një peshë më e lartë dhe për këtë master shkencor, objekt vlerësimi. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

7. **Për Objeksion/Sqarim të UMSH-së, lidhur me standartet II.6 – standartin IV.4. fq 31- 62 RVJ,** GVJ rekomandon që fondi i bibliotekës të pasurohet me literaturë kombëtare dhe ndërkombëtare që i përgjigjet 5 viteve të fundit. Përditësimi të jetë periodik dhe ti përgjigjet ndryshimeve në legjislacion dhe në praktikën gjyqësore sipas rastit. Gjithashtu, edhe syllabuset të përditësohen me literaturën përkatëse. GVJ rithekson nevojën e përditësimin me teskte bashkëkohore të bibliotekës fizike dhe asaj virtuale me tituj të përshtatshëm me lëndët e ofruara në masterin shkencor “E drejtë publike” dhe këto botimi duhet dhe të pasqyrohen dhe të përfshihen në programet e lëndëve të ofruara në këtë master. Në këtë pikë, stafi akademik i angazhuar në këtë master luan një rol parësor jo vetëm në përditësimin e teksteve të ofruara në lëndët e tyre por dhe në orientimin e studentëve drejt doktrinës dhe zhvillimeve më të fundit në fushat e tyre të interesit. **Raporti në këto pika nuk ndryshon.**

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr 63 datë 05.07.2019 janë:

1. Institucioni të rekrutojë staf të ri akademik efektiv, me qëllim uljen e ngarkesës së lartë mësimore të stafit akademik efektiv aktual të angazhuar në këtë program studimi;
2. Institucioni të përditësojë dhe të unifikojë syllabus-et në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”;
3. Institucioni të rrisë përfshirjen e studentëve të këtij programi studimi në kërkim shkencor si dhe të shtojë aplikimet në Projekte Erasmus dhe përfshirjen në to të studentëve dhe stafit akademik të këtij program studimi;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. **Refeuar rekomandimit të parë,** GVJ bazuar në dokumentacion dhe vizitën në institucion, konstatoi se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane ka punësuar dhe 2 (dy) anëtarë të rinj me kohë të plotë në Departamentin e së Drejtës. GVJ vëren një tendencë për përmirësimin e

shkallës së kualifikimit të PAE, gjë e cila duhet të vazhdojë edhe në vitet në vijim. GVJ rekomandon që institucioni:

- a) të vijojë me rekrutimin e stafit të ri akademik efektiv që duhet të përfshihet në mësimdhënie në ciklin e dytë master i shkencave në “E Drejtë Publike”;
- b) krijimin e një klimë të përshtatshme për një qëndrueshmëri në kohë të personelit akademik nëpërmjet asistimit dhe ndihmës efektive që stafi akademik të avancojë me pajisjen me grada dhe titujt e nevojshëm sikurse përcaktohet nga legjislacioni referues në fuqi;
- c) rritje cilësore të tij në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor.

Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**.

2. **Refeuar rekomandimit të dytë**, GVJ nga dokumentacioni dhe nga vizita në Institucion, konstatoi se ndonëse ka një përmirësim të dukshëm ka ende vend për rregullim dhe institucioni i ka kapacitetet për ta bërë këtë. Në këtë kuadër GVJ rekomandon me përparësi *rishikimin dhe përditësimin bashkëkohor të literaturës*;

- a) *pajisjen me kod të lëndëve*;
- b) *përkthimin në anglisht të syllabuseve*;
- c) *rishikimin e kurrikulës ekzistuese dhe orientimin drejt shtimit të lëndëve me zgjedhje*;
- d) *rishikimin e krediteve të lëndëve të ofruara në programin shkencor “E Drejtë Publike” dhe rritjen e krediteve për lëndët ndërdisiplinore dhe/ose lëndë me zgjedhje*;

Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur kryesisht**.

3. **Refeuar rekomandimit të tretë**, GVJ bazuar tek dokumentacioni dhe vizita në institucion, konstatoi se UMSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus+, si dhe ka një strategji të qartë mbi rëndësinë e ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimit me institucione si motra brenda dhe jashtë vendit. U konstatua që anëtarët e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane janë përfshirë dhe kanë përfituar nga marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit ku universiteti është palë. Gjithashtu GVJ konstatoi se Departamenti i së Drejtës ka efektiv klinikën e ligjit dhe zhvillon në mënyrë periodike konferenca shkencore me pjesëmarrjen e studentëve, mentoruar nga pedagogët e këtij departamenti. GVJ rekomandon që institucioni të intensifikojë nënshkrimin e marrëveshjeve Erasmus dhe rritjen e shkëmbimit të stafit akademik dhe të studentëve në kuadër të këtij programi. Në përfundim, GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**.



Poneuro!

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Publike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit DVV si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ arrin në gjykimin se programi i studimeve i Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Publike”, i ofruar nga i Departamenti i së Drejtës, Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Humane, Universitetin ‘Mesdhetar i Shqipërisë’, në të gjithë komponentët e tij, nuk bie ndesh me interesat kombëtare por ka si qëllim përmbushjen e këtyre interesave. Gjithashtu, programi i studimit master i shkencave në “E Drejtë Publike” është në përputhje me planin strategjik të zhvillimit të UMSH-së, Statutin dhe Rregulloren e Organizimit të UMSH-së si dhe Rregullore e programit të studimit MSCDP. Ev. nr. 4: Plani Strategjik i Zhvillimit të UMSH, f. 6 Misioni i UMSH-së për 5 vitet e ardhshme; f. 19 pika 3 tek paragrafi veprimet që do të ndërmerren; Ev. nr1 : Statuti; Ev. nr. 2 Rregullore e Organizimit të UMSH-së; Ev. nr. 8 Rregullore e programit të studimit MSCDP
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Fusha e programit të studimit në të drejtë publike është menduar të hartohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të arsimit të lartë në vend dhe nevojave të tregut për rritjen e kapaciteteve të administratës publike me qëllim formimin e ekspertëve në fushën e të drejtës publike, me njohuri të gjera në fushat e të drejtës së Institucioneve të Shtetit, të së drejtës kushtetuese, administrative, penale, ndërkombëtare dhe europiane. Ev. Nr. 8, Rregullore e programit të studimit MSCDP Neni 4;

	Ev. Nr. 5. Strategjia e Zhvillimit të programit të studimit MSC në të drejtë publike			
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Në Statutin e UMSH përcaktohet si qëllim ofrimi i studimeve universitare në programe të nivelit bachelor, master për formimin e studiuesve të rinj në fushat e shkencave të ndryshme, përfshirë dhe atë juridike dhe thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë, e për pasojë kontribuimin në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit. Ev. nr.1: Statuti, neni 4 pika 2 dhe neni 5			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Publike" ka si objektiv të realizojë formimin shkencor dhe profesional të specialistëve në fushën e së drejtës publike me qëllim pasisjen e studentëve me njohuri të thelluara në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut, administratën publike, etj, përmes një kurrikule që prek degë të ndryshme të së drejtës publike. Programi është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojën e vendit për jurist të kualifikuar në administratën publike ndërkohë që vendi përballlet me sfidën e integritimit në BE, zbatimin e reformës në drejtësi dhe nevojën e ripërtëritjes së specialistëve dhe kualifikimin profesional të tyre. Ev. 12. 1 Plani Mësimor			
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ vlerëson se programi i studimeve i Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Publike", i ofruar nga i Departamenti i së Drejtës, Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Humane, Universitetin 'Mesdhetar i Shqipërisë', në të gjithë komponentët e tij, nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të arsimit të lartë në vend dhe nevojave të tregut. Kurrikula e miratuar është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojën e tregut shqiptar për juristë të kualifikuar në të drejtën publike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Publike” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (sot Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane), njësia bazë, Departamenti i të Drejtës Publike. Misioni i këtij masteri shkencor është përgatitja e specialistëve cilësorë të së drejtës publike të aftë për t’iu përgjigjur nevojave të zhvillimit të administratës së brendshme dhe sfidave që vijnë për shkak të Shqipërisë si vend kandidat për t’u anëtarësuar në BE dhe zhvillimeve aktuale globale. Për realizimin e këtij misioni, Departamenti i së Drejtës mbështetet në një staf akademik total prej 19, ku 3 prej tyre mbaj titullin akademik profesor, 10 lektorë dhe 6 asistent lektor. Ndërsa stafi akademik i dedikuar për realizimin e programit të studimit të masterit në “E Drejtë Publike” përbëhet nga 7 PAE dhe 2 PAK të katedogrisë Prof. Asoc. dhe të kategorisë Dr. konform përcaktimeve ligjore në fuqi. Referuar fushës individuale të kualifikimit, GVJ konstatoi se personeli i angazhuar në programin e studimit master i shkencave në “E Drejtë Publike” disponon formimin e duhur për të garantuar një mësimdhënie cilësore. Nga takimet në institucion u konstatua që, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane kishte punësuar dhe dy anëtarë të rinj me kohë të plotë në Departamentin e së Drejtës, gjithashtu u konstatua se institucioni mbështet financiarisht stafin akademik në botimet e punimeve të tyre shkencore që janë të rëndësishme jo vetëm për rritjen cilësore të vetë stafit por dhe për një lekturim bashkëkohor dhe të larmishëm për studentët duke ndikuar pozitivisht në formimin e tyre profesional. GVJ është i mendimit që ka një tendencë për përmirësimin e shkallës së kualifikimit të PAE, gjë e cila duhet të vazhdojë edhe në vitet në vijim, duke ofruar në këtë mënyrë garanci suplementare, për një qëndrueshmëri në kohë të personelit akademik dhe rritje të nivelit cilësor jo vetëm të mësimdhënies, por edhe të kërkimit shkencor. Ev.nr. 5 Strategjia e Zhvillimit të programit të studimit MSC në të drejtë publike;

	Ev. Nr. 14 Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit MSCDP, Tabela nr. 6.3 që i referohet vitit akademik 2020-2021; Ev. Nr. 12.3. Cv e stafit akademik;
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” përbëhet nga 4 fakultete: 1. Fakulteti i Shkencave Ekonomike; 2. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane; 3. Fakulteti i Informatikës; 4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane organizohet në departamentet e mëposhtme: 1. Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave; 2. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë; 3. Departamenti i së Drejtës; 4. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Ku Departamenti i së Drejtës ofron programin e masterit shkencor në “E Drejtë Publike”. GVJ konstatoi se ka një përputhje ndërmjet fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, e veçanërisht të Departamentit të së Drejtës ku ofrohet programi i masterit objket vlerësimi. Duke ju referuar kërkesave të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përsa i përket kodifikimit të programit të masterit shkencor në të drejtë publike konstatohet se janë miratuar aktet nënligjore, të nevojshme për të realizuar këtë proces si: • Rregullore për organizimin dhe punën e fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane; • Rregullore e Departamentit të së drejtës; • Rregullore e Masterit Shkencor në të Drejtë Publike; Ev nr. 6 Rregullor e FDSHH; Ev nr 7 RRegullore e departamentit RDD; Ev nr 8 Rregullore e programit MSC DP;
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e	Misioni i Departamentit të së Drejtës është të promovoj studimin dhe kërkimin shkencor, jo vetëm në çështje të së drejtës publike,

programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitet bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	kushtetuese, administrative dhe ndërkombëtare por edhe të formojë profesionistë të specializuar të gatshëm për t'iu përgjigjur sfidave të kohës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion, GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të së Drejtës dhe të programit në master i shkencave në “E Drejtë Publike” të ofruar prej tij. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë organigramën e Universitetit dhe fushat e studimet të ofruara prej saj, <u>GVJ rekomandon që Departamenti i së Drejtës të ndërveprojë dhe me departamentet e tjera dhe stafet e tyre akademike me qëllim pasurimin e kurrikulës të programit të masterit shkencor në “E Drejtë Publike” dhe përgatitjen ndërdisiplinore të profesionistëve që të mund të adresohen në mënyrë më të përshtatshme sfidat e punësimit që gjithnjë e më shumë janë të orientuara drejt profesionistëve me përgatitje ndërdisiplinare.</u> Ev. Nr. 5 Strategjia e Zhvillimit të programit të Studimit MSC në E Drejtë Publike;
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Departamenti i së Drejtës në ofrimin e programit të masterit i shkencave në “E Drejtë Publike” në mënyrë të vazhdueshme ofron leksione të hapura me personalitete nga fusha e së drejtës si dhe aktivitete me dhe për studentët me institucione të ndryshme në vend. Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se UMSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus+, si dhe ka një strategji të qartë mbi rëndësinë e ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimit me institucione simotra brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të biznesit të cilat mbështesin realizimin e objektivave të programit të studimit. Ev. Nr 15. Leksione të hapura në DD; Ev. Nr. 9 Marrëveshje Bashkëpunimi; Ev. Nr. 21 Strategjia e ndërkombëtarizimit të UMSH; Ev. Nr 42. Marrëveshjet UMSH-Erasmus; Ev. Nr. 43. Zyra e marrëdhënieve me jashtë;

	Plani vjetor i punës për 2023-2024 i Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë, Erasmus+ dhe Projekte (dok shtesë);			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion me studentët e programit të studimit master i shkencave në “E Drejtë Publike”, GVJ konstatoi se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Departamenti i së Drejtës ka të qartë problematikat e tregut të punës dhe asiston studentët e këtij masteri në përmbushjen e praktikave profesionale pranë institucioneve të ndryshme si dhe studentët kanë mundësi të përfshihen në dhënien e asistencës ligjore pranë klinikës së ligjit të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane. Gjithashtu rezultojnë se në programin e masterit “E Drejtë Publike” në harkun kohor 2021-2023 janë 104 të diplomuar. Ev. Nr. 48. Statistika mbi numrin e studentëve të diplomuar/të punësuar të MSCDP; Ev. Nr. 13 Analiza e Tregut të punës;			
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstaton se Departamenti i së Drejtës ka kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e këtij programi studimi ndonëse nxiti Departamentin të rrisë bashkëpunimin edhe me departamentet e tjera dhe stafet e tyre akademike me qëllim pasurimin e kurrikulës të programit të masterit shkencor në “E Drejtë Publike për përgatitjen ndërdisiplinore të profesionistëve që përfundojnë këtë master.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të	Veprimtaria e programit të studimit master i shkencave në “E Drejtë Publike” organizohet dhe zhvillohet bazuar në Statutin e UMSH, Rregulloren e organizimit të UMSH, Rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Rregulloren e



Handwritten signature in blue ink

frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Departamentit të së Drejtës dhe rregulloren specifike për programin e MSCDP. Hartimi, mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit në master i shkencave 'E Drejtë Publike' është në kompetencë të Departamentit të së Drejtës dhe lidhet me elementë që kanë të bëjnë me aktivitetin mësimor-kërkimor të stafit akademik, botimet, pjesëmarrjet në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. <i>GVJ konstaton se programi i studimit Msc "E Drejtë publike" ka mundësi të përditësohet, përmirësohet dhe të pasurohet duke mbajtur në konsideratë resurset humane dhe programet e studimit të ofruara nga ky universitet.</i> Në mënyrë të veçantë, nisur dhe nga zhvillimet bashkëkohore të cikleve të studimit në master shkencor edhe në vende të tjera europiane dhe më gjerë si dhe duke mbajtur në konsideratë elementet e cilësisë dhe të rritjen së performancës akademike, kërkimin shkencor dhe zhvillimet e fundit në këtë fushë të studimit, <u>GVJ rekomandon</u> rishikimin e kurrikulës ekzistuese dhe orientimin drejt shtimit të lëndëve me zgjedhje, në mënyrë të tillë që studentet të mund të profilozen dhe të thellojnë njohuritë e tyre në mënyrë më të përpiktë. Ev. 1. Statuti UMSH; Ev. Nr. 2. Rregullore e Organizimit UMSH; Ev. N. 6 Rregullore e FDSHH; Ev. Nr. 7 Rregullore e Departamentit RDD; Ev. Nr. 8 Rregullore e programit MSC DP; Ev. Nr. 25. Programi i trajnimeve; Ev. Nr. 26. Përmbledhje e procedurës së rekrutimeve; Ev. Nr 36. Të dhëna tabelore për personelin akademik; Ev. Nr. 29. Plani i monitorimit DD;
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë	GVJ konstaton se, UMSH dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane ka bashkëpunime ndërinstitutionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës ku realizohen dhe praktikat profesionale të organizuara nga insitucioni apo dhe nga vetë studentët.

vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	<i>GVJ rekomandon që institucioni duhet të intensifikojë nënshkrimin e marrëveshjeve institucionale dhe të punojë për zbatimin efektiv të këtyre marrëveshjeve.</i> Bashkëpunimi me aktorë të tjerë të sektorit publik dhe privat do të ndikojë pozitivisht në kuadër të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve dhe pajisjen e tyre me kompetenca të nevojshme, si dhe vendosjen e kontakteve që mund të lehtësojnë në një të ardhme edhe në depërtimin e tregut të punës. Gjithashtu, këto bashkëpunime do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e eksperiencës të stafit akademik që mund të përkthehet në një përditësim bashkëkohor të syllabuseve dhe të përditësimit të literatures sipas nevojave konkrete të konstatuara nga bashkëpunimi me grupe të ndryshme interesi. Në këtë kontekst me rëndësi është dhe trajnimi dhe shkëmbimi i stafit akademik nëpërmjet projektit Erasmus+. Ev. Nr. 9 Marrëveshje Bashkëpunimi; Ev. Nr 42. Marrëveshjet UMSH-Erasmus; Lista e mobiliteteve incoming dhe outgoing _Staf (përcjellë me dok. Shtesë);
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.	Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Humane ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi si dhe është palë e marrëveshjeve Erasmus. Gjatë vizitës në institucion, GVJ kostatoi se Departamenti i së Drejtës ka efektiv klinikën e ligjit, në bazë të një procedure të paracaktuar përzgjedh studentët për t'u trajnuar në të. Gjithashtu u konstatua se Departamenti i së Drejtës zhvillon në mënyrë periodike konferenca shkencore me pjesëmarrjen e studentëve, mentoruar nga pedagogët e këtij departamenti dhe së fundmi ka organizuar dhe një vizitë studimore në Kosovë me pjesëmarrje të përzier pedagog dhe student, ku këta të fundit do të ketë mundësi të kenë takime nga afër me personalitete të fushës të së drejtës publike.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe nga takimi me grupet e ndryshme të interesit gjatë vizitës në institucion konstatohet se anëtarët e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane janë përfshirë dhe kanë përfituar nga marrëveshjet e

analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	ndryshme të bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit ku universiteti është palë. Megjithatë, <u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti së Drejtës dhe koordinatori i masterit shkencor në “E drejtë Publike” të hartojnë një model raporti analitik vjetor të përfitimeve që anëtarët e stafit akademik të këtij departamenti dhe studentëve që frekuentojnë masterin në “E Drejtë Publike” kanë realizuar në kuadër dhe të rritjes së cilësisë dhe funksionimit më praktik të programeve të studimit që mbulohen.			
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi i studimit “E Drejtë publike” ka nevojë të përditësohet, përmirësohet dhe të pasurohet duke mbajtur në konsideratë jo vetëm kapacitetet e këtij universiteti por dhe nevojat bashkëkohore që vendi po kalon. Ndër të tjera, në mënyrë të përmbledhur <u>GVJ rekomandon</u>: • rishikimin e kurrikulës ekzistuese dhe orientimin drejt shtimit të lëndëve me zgjedhje; • intensifikimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve institucionale me aktorë brenda dhe jashtë vendit për rritjen e cilësisë dhe të performancës akademike; • rritjen e shkëmbimeve të studentëve në programin erasmus+ dhe nxitjen e praktikave mësimore; • përditësimin bashkëkohor të syllabuseve dhe përditësim të literaturës sipas nevojave konkrete të konstatuara nga bashkëpunimi me grupe të ndryshme interesi të këtyre marrëveshjeve; • hartimin një model-raporti analitik vjetor të përfitimeve që anëtarët e stafit akademik të këtij departamenti dhe studentët që frekuentojnë masterin në “E Drejtë Publike” kanë realizuar në kuadër dhe të rritjes së cilësisë dhe funksionimit më praktik të programeve të studimit që mbulohen;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit master i shkencave “në E Drejtë Publike” është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). GVJ konstaton se programi i studimit në verifikim përmban të shprehura në mënyrë eksplicite shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj, të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore në fuqi. Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënës, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, etj. Programi i studimit master i shkencave në “E Drejtë Publike” ofrohet në 2 vite akademike të përkthyer në 4 semestra. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. Lëndët bazë të programit (formim i përgjithshëm, përgatitje metodologjike, kulturë e përgjithshme): A 5%-10% nga 12 ECTS; Lëndët karakterizuese (formim specifik sipas programit): B ECTS=50-60% nga 62 ECTS; Lëndët ndërdisiplinore integruese dhe/ose lëndë me zgjedhje: C 12-20% nga 16 ECTS; Lëndë plotësuese (gjuhë e huajt, informatikë, praktika): D 10% nga 12 ECTS; Detyrimet përmbyllëse (Teza e Diplomës ose provim përfundimtar): E 10-15% nga 18 ECTS; <i>GVJ rekomandon një rishikim të lëndëve dhe krediteve të tyre duke treguar më kujdes më shpërndarjen e krediteve ndërmjet</i>

 Konaçi

	<i>kategorive të ndryshme dhe rritjen e krediteve për lëndët ndërdisiplinore dhe/ose lëndë me zgjedhje.</i> Ev. Nr. 12.1 Plani Mësimor MSCDP 2022-2023;
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Objektivat e masterit i shkencave në “E Drejtë Publike” ka për qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve në fushën e së drejtës publike, formimin teorik dhe praktik të tyre dhe thellimin e njohurive shkencore në fushën e së drejtës publike. Veprimtaritë formuese të programit janë të formimit të përgjithshëm dhe atij karakterizues (gjithsjes 92 ECTS), praktikë profesionale (10 ECTS) dhe Teza e Diplomës (18 ECTS). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion me drejtuesit e Departamentit dhe pedagogët që mbulojnë lëndët në këtë program studimi, GVJ konstaton se lëndët e ofruara në këtë kurs studimi rimarrin, trajtojnë dhe thellojnë çështje/ tematika që në pjesën kryesore të tyre duhet të jenë të përvetësuar nga studentët në programin bachelor. Kjo dhe për shkak të faktit se një pjesë e studentëve që janë pjesë e këtij masteri nuk kanë përvojë në fushën e drejtësisë sepse vijnë nga kurse të tejera studimi të një natyre jo juridike, si shkencat sociale. Me qëllim zhvillimin e kompetencave specifike në fushën e së drejtës publike dhe specializimin në zgjidhjen e problemeve komplekse që vijnë nga praktika e punës në administratën publike, <u>GVJ rekomandon që programi i studimit dhe syllabuset e tij të jenë të prirur kryesisht drejt trajtimit të çështjeve konkrete/jurisprudencë të cilat hasen në praktikë dhe përbëjnë dhe një sfidë për administratën publike në punën e tyre të përditshme.</u> Evidenca 8. Rregullore e programit MSC DP; Evidenca 12.1. Plani mësimor MSC DP; Ev. Nr. 12.2. Syllabuset e lëndëve për vitin akademik; Ev. Nr. 8. Rregullore e programit MSC DP Neni 4;
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit Msc në “E drejtë Publike” ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse si më poshtë:



	Intership (kualifikim profesional) zhvillohet semestrin e katërt, veprimtaria formuese D, 12 ECTS, 240 orë në auditor, 60 orë e pavavur gjithësej 300 orë; Diploma zhvillohet semestrin e katërt, veprimtaria formuese E, 18 ECTS, 30 orë në auditor, 420 orë e pavavur gjithësej 450 orë; Ev. Nr. 11. Udhëzim për praktikat dhe formularët e praktikës mësimore;
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N/A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N/A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se pranimi i studentëve dhe financimi i tyre për të ndjekur studimet në institucionet e arsimit

financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	të lartë realizohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu konstatohet dhe vëmendje drejtuar studentëve me aftësi ndryshe. Ev. Nr. 18. Rregullore për studentet me aftësi ndryshe;
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit në ciklin e dytë master i shkencave ofrohet në mbi 70% me përmbajtje të ngjashme me fushën e së drejtës publike. Evidenca 12.1. Plani mësimor MSC DP; Ev. Nr. 12.2. Syllabuset e lëndëve për vitin akademik;
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion konstatohet se lëndët që ofrohen më programin e studimit të ciklit të dytë master i shkencave në 'E drejtë Publike' nuk janë të pajisura me kodin përkatës. <i>GVJ rekomandon Departamentin e së Drejtës dhe Drejtuesin e Masterit Shkencor "E Drejtë Publike" të marrë masa për të përmbushur sa më parë këtë detyrim.</i> Ev. 12.2. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023;
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Duke mbajtur në konsideratë organizimin e Universitetit, departamentet e tij, lëndët që ofrohen stafi akademik dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me ILA të tjera vendase dhe të huaja, <i>GVJ rekomandon rishikimin e lëndëve që ofrohen në këtë kuadër, për ta bërë programin më tërheqës dhe bashkëkohor si dhe të përshtatshëm për përballimin e sfidave të kohës.</i>
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave "E Drejtë Publike" është në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe se programi i studimit në ciklin e dytë master i shkencave ofrohet në mbi 70% me përmbajtje të ngjashme me fushën e së drejtës</i>



	publike. Gjithashtu, institucioni ka në vëmendje dhe studentët me aftësi ndryshe. GVJ konstatoi se lëndët që ofrohen më programin e studimit të ciklit të dytë master i shkencave 'E drejtë Publike' nuk janë të pajisura me kodin përkatës dhe inkurajon institucionin të përmbush këtë detyrim ligjor. Gjithashtu GVJ rekomandon që programi i studimit dhe syllabuset e tij të rishikohen duke patur në fokus trajtimin trajtimit të çështjeve konkrete/jurisprudencë të cilat hasen në praktikë dhe që janë bashkëkohore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve											
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 4 njësi bazë: 1. Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave; 2. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë; 3. Departamenti i së Drejtës; 4. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Duke përmbushur kështu edhe kriteret ligjore për qëndrueshmërinë e njësisë kryesore. Fakulteti Drejtësisë dhe Shkencave Humane, për vitin akademik 2022-2023, ka gjithsej 67 pedagogë, nga të cilët 51 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 16 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>4</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.Asoc</td><td>6</td><td>1</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane		PAE	PAK	Prof.Dr	4	1	Prof.Asoc	6	1
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane											
	PAE	PAK										
Prof.Dr	4	1										
Prof.Asoc	6	1										



Komiteti

Dr/PhD	28	8
Msc	13	6
Gjithsej	51	16

Departamenti i së Drejtës, përgjegjës për programin e studimit përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas tre viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	1	-	2	-
Prof. Asoc.	1	2	2	1	2	1
Dr./PhD.	10	1	7	2	11	2
Msc.	1	2	1	1	2	4
Totali	13	5	11	4	17	7

Secila njësi bazë, përfshirë edhe Departamentin e së Drejtës, përmbush kriteret minimale të parashikuar në ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësive bazë.

Nga sa më sipër njësia kryesore / bazë plotësojnë kriteret ligjore për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor. Megjithatë, *GVJ rekomandon vëmendje nga ana Fakultetit dhe e njësive bazë për nevojën e krijimit të një klime të përshtatshme për rritjen profesionale të stafit të kësaj njësie për t'u dhe pajisur me gradat dhe titujt e nevojshëm sikurse përcaktohet nga legjislacioni referues në fuqi.*

Ev. Nr. 12.3. Cv e stafit akademik;

Ev. Nr 36 te dhena tabelore per personelin akademik Mscdp;

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik

UMSH angazhon në zhvillimin e procesit mësimor, staf ndihmës akademik për mbarrëvajtjen e aktiviteteve mësimore në tërësi. Bazuar në rregulloren e programit të studimit është e shprehur qartë që përgjegjësi i departamentit është përgjegjës për ecurinë e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion dhe takimin me studentët u evidentua që Departamenti i së Drejtës kishte caktuar koordinators (kujdestar), me detyra të përcaktuara qarte

Handwritten signature in blue ink.

/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi. Ev. Nr. 1. Statuti UMSH; Ev. Nr. 2. Rregullore e Organizimit UMSH; Ev. Nr. 3. Organigrama UMSH; Ev. Nr. 4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH; Ev. Nr. 5. Strategjia e zhvillimit të programit MSC e drejtë publike; Ev. Nr. 6. Rregullor e FDSHH; Ev. Nr 7. Rregullore e departamentit RDD; Ev. Nr. 8, Rregullore e programit MSC DP;		
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Bazuar në Kreun II, Struktura Organizative e Rregullores së programit të studimit master i shkencave në 'E drejtë Publike' (MSCDP) koordinators dhe përfaqësues i programeve master është Përgjegjësi i Departamentit të së Drejtës. (Neni 6, Rregullore e programit MSC DP). Gjithashtu nga neni 7 i Rregullores së programit MSC DP përcakton qartë detyrat dhe kompetencat e koordinatorit në përputhje me zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale të nevojshme për realizimin e këtij cikli studimi. Ev. Nr. 8, Rregullore e programit MSC DP;		
Konkluzione	<i>Në përfundim GJV vlerëson se Departamenti i së Drejtës si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit plotëson kriteret ligjore dhe ka një staf akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë në të drejtën publike si dhe ka caktuar koordinators (kujdestar), me detyra të mirëpërcaktuara për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.



Komiteti

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Dokumentat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor janë të plota. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e Programit të studimit, Rregulloren e Departamentit t, Planin strategjik të UMSH, Planin mësimor, kurrikulën e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, etj. Ev. 2. Rregullore e Organizimit UMSH; Ev 6. Rregullor e FDSHH; Ev 7. Rregullore e departamentit RDD; Ev 8. Rregullore e programit MSC DP; Ev 4. Planin strategjik i zhvillimit UMSH; Ev 12.1. Planin mësimor MSCDP 2022-2023;
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ konstaton se në planin mësimor të masterit shkencor “E Drejtë Publike” veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM 41 si më poshtë: <i>Lëndët bazë të programit (formim i përgjithshëm, përgatitje metodologjike, kulturë e përgjithshme):</i> A 5%-10% nga 12 ECTS; <i>Lëndët karakterizuese (formim specifik sipas programit):</i> B ECTS= 50-60% nga 62 ECTS; <i>Lëndët ndërdisiplinore integruese dhe/ose lëndë me zgjedhje:</i> C ECTS= 12-20% nga 16 ECTS; <i>Lëndë plotësuese (gjuhë e huaj, informatikë, praktika):</i> D ECTS= 10% nga 12 ECTS; <i>Detyrimet përmbyllëse (Teza e Diplomës ose provim përfundimtar):</i> E ECTS= 10-15% nga 18 ECTS; Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi përmban 12 lëndë të shpërndara në dy semestra të vitit akademik plus praktikën mësimore dhe mbrojtjen e diplomës. Në planin mësimor paraqiten të qarta ndarja e orëve në leksion dhe seminar si dhe

Asmund



	orët që i dedikohen punës së pavarur të studentëve dhe orët jashtë auditorit. Ev 12.1.Plani mësimor MSCDP 2022-2023;
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion me studentët, GVJ konstaton se programi i studimit ofron informacione të qarta në lidhje me kriteret e përgjithshme të pranimit, të programit mësimor të ofruar dhe asistencën që studentët kanë gjetur pranë zyrave të IAL-së. <i>Megjithatë GVJ vlerëson se në faqën e internetit të UMSH të krijohet mundësia e dhënien së një informacioni të qartë çelës mbi procedurat e transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve sepse kjo të lehtësonte informimin më të mirë të studentëve.</i> Ev. Nr. 20. Udhëzuesi i studentëve; Ev. Nr. 37. Udhëzim mbi procedurat dhe afatet e provimeve; Ev. Nr. 51. Programi i Bursave; Ev. Nr. 49. Të dhëna nga faqja zyrtare e UMSH;
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i programit mësimor dhe syllabuseve rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite në përputhje me VKM 41. Gjatë vizitës GVJ konstatoi gjithashtu se Departamenti i së Drejtës ka funksionale dhe klinikën e ligjit ku mund të trajnohen dhe të përfitojnë dhe studentët e masterit shkencor në “E Drejtë Publike”. Ev 12.1.Plani mësimor MSCDP 2022-2023; Ev. 12.2. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023; Plani vjetor i punës 2022-2023 dhe 2023-2024 Klinika Ligjore (dok shtesë);
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe	Me urdhërin nr. 346 datë 17.09.2015, nr. 6974 Prot. Datë 17.09.2015 , Ministra e Arsimit dhe Sportit ka urdhëruar hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë ‘Master i Shkencave’ në “E Drejtë Publike” dhe me vendimin nr. 38, datë 19.05.2017 është realizuar akreditimi i parë i këtij programi studimit. Në shtojcën e këtij vendim, Bordi i Akreditimit kishte lënë disa detyra për Institucionin si ndarjen e barabartë të krediteve në dy

Romirë

[Signature]

arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	vite dhe shmangien e mbingarkesës mësimore dhe qartësimin e kompetencave ndërmjet koordinatorit të programit të masterit dhe Shefit të Departamenti të cilat janë rezultojnë të plotësuar nga akreditimi periodik vijues. Ndërsa me vendimin nr. 63, datë 05.07.2019 për akreditimin periodik, Bordi i Akreditimit kishte lënë si detyrë: (i) rekrutimin e stafit të ri akademik efektiv, me qëllim uljen e ngarkesës mësimore për të stafit akademik efektiv; (ii) nevojën për përditësimin dhe unfikimin e syllabuseve në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 dhe përfshirjen e studentëve të këtij programi në kërkimin shkencor, kryesisht në projektet Erasmus; Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se njësia bazë ka rektutuar dy anëtarë të rinj të stafit akademik efektiv si dhe rritur përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor nëpërmjet realizimit të konferencave shkencore, përbashkëta me pedagogët e këtij universiteti, vizitave studimore në vende të tjera dhe në projektet Erasmus+. Përsa i përket nevojës për përditësimin dhe unfikimin e syllabuseve në përputhje me vkm-në nr. 41, konstatohet se ndonëse ka një përmirësim të dukshëm ka ende vend për rregullim dhe institucioni i ka kapacitetet për ta bërë këtë. Kështu, <u>GVJ rekomandon rishikimin dhe përditësimin bashkëkohor të literaturës, pajisjen me kod të lëndëve si dhe përkthimin në anglisht të syllabuseve. Gjithashtu, sikurse është përmendur dhe më lartë në këtë raport sugjerohet një rishikim i lëndëve të ofruara dhe të numrit të krediteve të tyre me qëllim pasurimin e dijeve të studentëve që frekuentojnë këtë program studimi me informacionet e nevojshme dhe për të qenë specialistë të kësaj fushe studimi dhe për t'iu përgjigjur efektivisht sfidave të kohës.</u> Lista e personelit akademik të rekrutuar; Planifikimi i vizitës studimore në Kosovë; Lista e mobiliteteve incoming dhe outgoing Student; Plani vjetor i punës për 2023-2024 i Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë, Erasmus+ dhe Projekte;
---	---


	Ev. 12.2. Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023;			
Konkluzione	Në përfundim GJV konstaton se Departamenti i së Drejtës, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit; Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit si dhe të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Gjithashtu pranë Departamentit është funksionale klinika e ligjit ku mund të trajnohen dhe të përfitojnë studentët e masterit shkencor në “E Drejtë Publike”. Nga ana tjetër GJV rekomandon: (i) përditësimin dhe unifikimin e syllabuseve në përputhje me vkm-në nr. 41; (ii) përditësimin bashkëkohor të literaturës, pajisjen me kod të lëndëve si dhe përkthimin në anglisht të syllabuseve; (iii) rishikim i lëndëve të ofruara dhe të numrit të krediteve të tyre me qëllim pasurimin e dijeve të studentëve që frekuentojnë këtë program studimi;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	Duke analizuar syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit master i shkencave në “E Drejtë Publike” si dhe nga takimet në institucion me stafin akademik, <u>GJV rekomandon rishikimin dhe përmirësimin e emërtimeve dhe të përmbajtjes së lëndës me qëllim dallimin në mënyrë të përshtatshme të lëndëve që zhvillohen me ciklin e mëparshëm të studimit dhe thellimit të tyre në këtë cikël studimi.</u>

Atkinson



mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<i>Gjithashtu rekomandohet që nga ana e personelit akademik t'i kushtohet kujdes këtij procesi, duke përditësuar syllabuset me zhvillimet më të fundit, pasuruar me praktikën gjyqësore, rifreskuar tekstet mësimore dhe rritur kapacitetin e studentëve në kërkimin e pavarur shkencor për të mundësuar angazhimin sa më efektiv të tyre dhe përfitimin maksimal të dijeve që vërtet të mund të shërbejnë në punësimin e tyre të afërt.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe kërkimit shkencor.	GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënës dhe të aftësisht profesional. <i>Megjithatë rekomandohet që të rishikohen lëndët dhe kreditet e tyre me qëllim ofrimin e një programi studimi sa më koherent dhe formues për studentët, duke synuar formimin më të profilizuar kryesisht në të drejtën publike dhe nëndegët e saj.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se lëndët janë kryesisht në përputhje me profilin e programit të studimit në master shkencor ndonëse sikurse u përmend dhe më lart ka hapsirë dhe mundësi për një përmirësim të tyre me qëllim formimin profesional të specialistëve në këtë fushë. Nga vizita në institucion gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se raporti teori-praktikë është në përputhje me ciklin e studimit ndonëse jo plotësisht i qartësuar dhe fiksuar në syllabuset e lëndëve. Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion/Seminare dhe praktika mësimore dhe Departamenti i së Drejtës ka bërë një shpërndarje të krediteve në aktivitete formuese që janë në përputhje me programin e studimit. Ev. Nr 12.1. Plani mësimor MSC DP; Ev. Nr. 12.2. Syllabuset e lëndëve për vitin akademik; Ev. Nr. 27. Kalendari akademik; Takime në institucion datë 12.02.2024;
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e	Gjatë takimit me personelin akademik dhe me studentët GVJ konstatoi se raportet midis formimit teorik dhe praktik janë të balancuara dhe mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve në fushën e të drejtës publike dhe të kontribuimit të tyre në administratën publike. E thënë ndryshe,

Monica

[Signature]

objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	orët në auditor për përgatitjen praktike (Seminare, projekte praktikë, klinikë ligjore, etj) janë evidente. Megjithatë, <i>GVJ gjykon dhe rekomandon që raporti i tyre të jetë jetë në përputhje me ciklin e dytë të studimeve, pra e orientuar kryesisht në formimin praktik të tyre dhe të pasqyrohet më mirë në syllabueset e lëndëve.</i> Takime në institucion datë 12.02.2024;
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Titulluari i lëndës si dhe koordinatori i masterit shkencor në “E Drejtë Publike” kanë përgjegjësinë të kontribuojnë dhe të verifikojnë që syllabuset e lëndëve të përmbajnë gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Qëllimi i përditësimit të programeve të lëndëve duhet të jetë përparësi në çdo fillim viti akademik dhe duhet të jetë në përputhje me evoluimin e së drejtës, prioritet dhe strategjinë e zhvillimit të vendit dhe me vetë kërkesat e tregut ku synon të integrohen studentët e diplomuar në këtë master. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, <i>GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve të studimit të masterit shkencor “E Drejtë Publike” kanë nevojë të dukshme për përditësim me evoluimin e së drejtës në këtë fushë dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar nuk është e viteve të fundit.</i> Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se UMSH investon në blerjen e literaturës së kërkuar nga stafi akademik, kur kjo kërkohet si dhe financon botimet shkencore të vetë stafit akademik. Për këtë arsye, <i>GVJ, rekomandon që koordinatori i masterit shkencor “E Drejtë Publike” duhet me përparësi të nxisë stafin akademik të këtij masteri të identifikojë pa vonesë literaturën e nevojshme dhe të bëjë përditësimet e nevojshme, duke përfshirë për shembull, vendimet e fundit të gjykatës europiane të drejtësisë apo të gjykatave të vendit mbi çështje bashkëkohore dhe me interes, artikuj të ndryshëm shkencorë nga autorë vendas dhe të huaj.</i>

	<i>Gjithashtu, GJV rekomandon që puna dhe kërkimi shkencor i anëtarëve të stafit akademik të masterit shkencor “E Drejtë Publike” duhet të orientohet në botime që i shërbejnë përmirësimit të kurrikulës dhe të lëndëve që ofrohen.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ konstaton, se syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit master shkencor “E drejtë Publike”, në përgjithësi ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të studentëve. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë ciklin e studimit në të cilin ofrohet ky master, <i>GVJ rekomandon që lëndët e ofruara dhe në disa raste përmbajtja e tyre duhet të përmirësohet me qëllim garantimin e dijeve dhe kompetencave që i përshtaten diplomës së masterit shkencor ku niveli i njohurive duhet të jetë më specifik dhe i specializuar.</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit master shkencor “E Drejtë Publike” u jep mundësi studentëve të konkurrojnë në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Veçanërisht nga takimi me studentët, GJV, konstaton se, programi i studimit kombinon teorinë me praktikën dhe u siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e së drejtës. Megjithatë sikurse u përmend dhe më lart, elementët teorikë dhe ata praktikë duhet të pasqyrohen në mënytë të detajuar dhe të fiksohen në programet e lëndëve të këtij masteri.
Konkluzione	<i>Në përfundim GJV konstaton se në përgjithësi ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave që përndjek masteri shkencor në “E Drejtë Publike”. Gjithashtu u konstatua se UMSH investon në blerjen e literaturës së kërkuar nga stafi akademik si dhe për botimet e tyre shkencore.</i> <i>Nga ana tjetër GJV rekomandon:</i> <i>(i) rishikimin dhe përmirësimin e emërtimeve dhe të përmbajtjes së lëndës me qëllim dallimin në mënyrë të përshtatshme të lëndëve që zhvillohen me ciklin e mëparshëm të studimit dhe thellimit të tyre në këtë cikël studimi;</i> <i>(ii) personelin akademik të përditësojë syllabuset me evoluimin bashkëkohor të së drejtës, duke e pasuruar me praktikën gjyqësore, rifreskuar tekstet mësimore;</i> <i>(iii) të investohet në rritjen e kapaciteteve të studentëve në kërkimin e pavarur shkencor për të mundësuar angazhimin</i>

	sa më efektiv të tyre duke synuar formimin më të profilizuar kryesisht në të drejtën publike dhe nëndegët e saj. (iv) që kërkimi shkencor i anëtarëve të stafit akademik të masterit shkencor "E Drejtë Publike" i financuar nga ky universitet të orientohet në botime që i shërbejnë përmirësimit të kurrikulës dhe të lëndëve që ofrohen;		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se 'Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane', dhe Departamenti i së Drejtës, falë punës së tij dhe kapaciteteve njerëzore në gjirin e tij bashkëpunon me brenda dhe jashtë vendit me partner të besueshëm dhe ka vendosur ura komunikimi me aktorë të ndryshëm të biznesit në vend dhe në mënyrë të vazhdueshme ofron leksione të hapura me personalitete të së drejtës që ofrojnë për studentët e këtij masteri një këndvështrim ndryshe që mund të shërbejë dhe për përmirësimin e programit të studimit të këtij masterit dhe të mundësojë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmërinë dhe kërkesat e tregut të punës. <i>GVJ rekomandon që Departamenti të hartojë një draft-strategji përsa i përket konsultimit periodik dhe të vazhdueshëm me aktorë të rëndësishëm brenda dhe jashtë vendit për të përthithur në mënyrë konkrete nevojat efektive të tregut të punës dhe për ti përkthyer më pas në përmirësimin e tematikave të ofruara nga në lëndët e këtij kursi studimi.</i> Gjithashtu sikurse përmendet dhe më lartë në këtë raport, duke qenë se ky kurs studimi ka pak vite që është hapur, GVJ fton institucionin të rrisë bashkëpunimin me palët e treta. Ev. Nr. 27. Kalendari akademik;

	Ev. Nr 42. Marrëveshjet UMSH-Erasmus +; Lista e mobiliteteve incoming dhe outgoing_Staf;
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstaton se njësia bazë përfshin studentët dhe strukturat e tyre nëpërmjet anketimeve periodike si dhe në organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta. Gjithashtu institucioni ka të qartë strategjinë e konsultimit dhe ruajtjen e kontakteve dhe me studentët e diplomuar të cilët mund të japin kontributin e tyre në përmirësimin e programit të studimit duke sjellë shembullin e tyre konkret. Ev. Nr. 28. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese; Ev. Nr. 41. Raporti i ALUMNI;
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	GVJ nxit Departamentin e së Drejtës të rrisë konsultimin me aktorë të ndryshëm në vend, veçanërisht me organet e reja të drejtësisë si dhe me institucione të tjera që operojnë në vend për të kuptuar më mirë nevojat e tyre dhe ato të tregut që të mund të përkthehen në përmirësim dhe përditësimin të programit të studimit.
Konkluzione	<i>Në përfundim, GVJ konstaton se njësia bazë përfshin studentët dhe strukturat e tyre nëpërmjet anketimeve periodike si dhe në organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta dhe ka krijuar ura komunikimi me studentët e diplomuar në këtë institucion.</i> <i>Megjithatë, GVJ nxit Departamenti e së Drejtës dhe koordinatorin e proramit të studimit në "E drejtë Publike" të rrisë bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm në vend, veçanërisht me organet e reja të drejtësisë si dhe të hartojë një draft-strategji përsa i përket konsultimit periodik dhe të vazhdueshëm me aktorë të rëndësishëm brenda dhe jashtë vendit për të përthithur në mënyrë konkrete nevojat efektive të tregut të punës dhe për t'i</i>

	<i>përkthyer më pas në përmirësimin e tematikave të ofruara nga në lëndët e këtij kursi studimi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në Statutin e UMSH përcaktohet se misioni i këtij institucioni është ofrimi i një game të plotë të programeve të studimit, përfshirë dhe fushat e shkencave juridike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë shqiptare, zhvillimin e dijeve dhe thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistëve të lartë. Ndërsa <i>neni 4</i> i Rregullores së programit të studimit master i shkencave në “E Drejtë Publike” detajon se qëllimi i këtij masteri është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në institucionet publike dhe thellimin e njohurive shkencore në fushën e së drejtës publike dhe përgatitjen e ekspertëve për këtë qëllim. Për sa më sipër, programi i studimit master shkencor në “E Drejtë Publike”, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin e UMSH-së. Ev. Nr. 8, Rregullorja e MSCDP; Ev. Nr. 5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSC në ‘E Drejtë Publike’; Ev. Nr. 1, neni 4 Statuti i UMSH;
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Publike” është krijuar si pjesë përbërëse e strukturës së Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, ku Departamenti i së Drejtës është autoriteti përgjegjës dhe koordinatori i këtij programi dhe bashkërendon punën në shpërdarjen e ngarkesës mësimore dhe organizimin e personelit akademik në mbulimin dhe ofrimin e veprimtarive shkencore dhe kërkimore. Gjithashtu, njësia kryesore bën analiza periodika për verifikimin e punës mësimore e shkencore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe nga takimet në institucion me stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë master, GVJ konstaton se institucioni

Hoanice



	respektin lirinë akademike të personelit akademik dhe nxit dhe promovon rritjen e tyre shkencore e profesionale edhe duke financuar projektet dhe botimet e tyre. Procedura per rimbursim publikimi shkencor_monografi shtuar me dok. Shtesë mbas konsultimit në institucion; Ev. Nr. 6, Rregullor e FDSHH; Ev. Nr. 8, Rregullorja e MSCDP; Ev. Nr. 47. Rregullore për organizimin e punës dhe zhvillimit të kurrikulave; Ev. Nr 46. Formulari i vetëvlerësimit; Ev. Nr 28. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese; Ev. Nr 23. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët;
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nga takimet në institucion me studentët e programit të studimit master shkencor në 'E Drejtë Publike', GVJ konstaton se studentët nxiten dhe motivohen të marrin pjesë në aktivitete shkencore të përbashkëta me stafin akademik si organizimi i konferencave shkencore, vizitat studimore apo aksesit dhe përfitimi i praktikës së punës në klinikën e ligjit të këtij departamenti.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Nga takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit master shkencor në "Drejtë Publike", GVJ konstaton se institucioni mbështet financiarisht kërkimin shkencor dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kërkimore dhe shkencore duke evituar pengesat burokratike dhe duke respektuar një procedurë standarde. Procedura per rimbursim publikimi shkencor_monografi;
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se programi i studimit master i shkencave në "Drejtë Publike" përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhore të institucionit. Njësia kryesore bën analiza periodika për verifikimin e punës mësimore e shkencore dhe respekton lirinë akademike të pedagogëve dhe nxit rritjen e tyre shkencore e profesionale edhe nëpërmjet financimit të punës së tyre shkencore duke evituar pengesat burokratike dhe duke respektuar një procedurë të paracaktuar dhe standarde.</i>

Arbore



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Përgjegjësi i Departamentit të së Drejtës është përgjegjës për të ndjekur vazhdimësinë e procesit mësimor, organizimin e punës për hartimin e programeve dhe lëndëve të ofruar në këtë master si dhe ndjek dhe kontrollon aktivitetin shkencor sipas planifikimit vjetor afatgjatë të kësaj veprimtarie. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse mbështet grupet kërkimore-shkencore dhe për këtë qëllim janë nënshkruar një sërë marrëveshje bashkëpunimi si dhe financon punën shkencore të stafit akademik. Nga ana tjetër, <u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti i së Drejtës duhet të intensifikojë përpjektet dhe të bashkëpunojë ngushtë edhe me Departamentet e tjera të këtij Fakulteti me qëllim shfrytëzimin më të mirë të resurseve njerëzore për ofrimin e një programi studimi ndërdisiplinor dhe bashkëkohor që më mirë të mund t'i përgjigjet nevojave për përmirësimin e syllabuseve të ofruara në këtë program studimi. Ev. Nr. 8, Rregullorja e MSCDP; Ev. Nr. 9. Marrëveshje bashkëpunimi;
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse angazhon në mënyrë të vazhdueshme personelin akademik dhe studentët në projekte të ndryshme, si konferenca shkencore, studime studimore, leksione të hapuara me personalitete të njohura të fushës të së drejtës apo përfitime nga mobiliteti Erasmus+. Gjithashtu, GVJ konstatoi që klinika e ligjit është funksionale dhe studentët kanë mundësi të rriten profesionalisht edhe nga pikëpamja praktike.

	Plani vjetor i punës 2022-2023 dhe 2023-2024 Klinika Ligjore; Ev. Nr. 9 Marrëveshje bashkëpunimi; Ev. Nr 15. Leksione të hapura në DD; Ev. Nr. 42. Marrëveshjet UMSH-Erasmus +; Lista e mobiliteteve incoming dhe outgoing_Staf; Lista e mobiliteteve incoming dhe outgoing_Student;
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse organizon konferenca shkencore ku përcaktohet dhe pjesëmarrja e studentëve, leksione të hapura me personalitete të fushës që sjellin praktikën nga përditshmëria dhe eksperiencën e tyre dhe që i shërben personelit akademik dhe studentëve në rritjen e tyre profesionale dhe në nxitjen e mendimit kritik. Ev. Nr. 15 Leksione të hapura në DD; Ev. Nr. 38 Aktivitetet shkencore të UMSH;
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe nga takimet në institucion, <u>GVJ rekomandon</u> që njësia përgjegjëse ka mundësi të përmirësojë programin e studimit në masterin shkencor “E Drejtë Publike” dhe të përfshijë në syllabuset e ofruara prej tij edhe tema bashkëkohore që i përgjigjen sfidave që po kalon vendi si dhe nevojës për realizimin e strategjisë së ndërkombëtarizimit. Në këtë kuadër, <u>GVJ rekomandon</u> përditësimin e syllabuseve si dhe përkthimin e tyre në anglisht. Ev 5. Strategjia e zhvillimit të programit MSC e drejtë publike; Ev. Nr. 21 Strategjia e Ndërkombëtarizimit e UMSH;
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të rëndësishëm në vend si AMF, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Ministria e drejtësisë etj. Së pari është e rëndësishme që këto marrëveshje të jenë efektive dhe t'i shërbejnë nevojave të insitucionit. Gjithashtu, <u>GVJ rekomandon</u> rritjen e bashkëpunimit edhe me organet e reja të drejtësisë që lindën si pasojë e reformës në Drejtësi por dhe me institucione të tjera të rëndësishme që operojnë në fushën e së drejtës dhe që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë jo vetëm në zhvillimin e praktikave mësimore për studentët dhe mundësinë për punësimin e tyre të ardhshëm por

Konurci

	edhe për të evidentimin e nevojave të këtyre institucione që mund të përkthehen në përmirësim të kurrikulave mësimore të ofruara në masterin shkencor “E Drejtë Publike”. Ev. Nr. 9. Marrëveshje bashkëpunimi;
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit master i shkencave në “E Drejtë Publike” është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai ofrohet në 2 vite akademike dhe në katër semetra dhe është organizuar sipas programit të studimit me kohë të plotë në gjuhën shqipe. Në përfundim të këtij programi studimi, studenti fiton 120 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune e pavarur e studentit. Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë; VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr.879, date 18.12.2019; Ev. Nr. 12.1 – Plani Mësimor MSCDP 2022-2023; Ev. Nr. 8 Rregullore e programit të studimit Master I Shkencave në MSCDP;
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse mbështet grupet kërkimore-shkencore dhe janë nënshkruar një sërë marrëveshje bashkëpunimi si dhe financon punën shkencore të stafit akademik. Njësia përgjegjëse angazhon në mënyrë të vazhdueshme personelin akademik dhe studentët në projekte të ndryshme, si konferenca shkencore, studime studimore, leksione të hapuara me personalitete të njohura të fushës të së drejtës apo përftime nga mobiliteti Erasmus+. Gjithashtu u konstatua se klinika e ligjit është funksionale dhe studentët kanë mundësi të rriten profesionalisht edhe nga pikëpamja praktike. Programi i studimit master shkencor në “E Drejtë Publike” përputhet me</i>

	aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian. Megjithatë <u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti i së Drejtës dhe koordinatori i këtij masteri duhet të intensifikojë përpjekjet dhe të bashkëpunojë ngushtë edhe me Departamentet e tjera për ofrimin e lëndëve ndërdisiplinore si dhe rekomandon rritjen e bashkëpunimit me organet e reja të drejtësisë por dhe me institucione të tjera të rëndësishme në vend në mënyrë të tillë që zhvillimi i praktikave mësimore për studentët të përkthehen në mundësi punësimi në të ardhmen..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1


Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Baza e realizimit të procesit mësimor në auditor është ora mësimore. Ndër format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit dhe praktika mësimore. GVJ konstatoi se format klasike të mësimdhënies ndërthuren me metoda të ndryshme bashkëkohore. Gjithashtu, GVJ konstatoi se në mënyrë të vazhdueshme, Fakulteti organizohen edhe leksione nga lektorë të ftuar. Nga diskutimi me pedagogët dhe studentët e programit, GVJ u informua për mënyrën e zhvillimit të lëndëve të ndryshme dhe në mënyrë të veçantë për peshën e elementëve

	formues të parashikuar në secilën lëndë si dhe mundësinë e përfitimimit nga Klinika e Ligjit. Në këtë kuadër, <u>GVJ do të rekomandonte</u> një rritje të peshës së praktikës në elementët formues të programit, duke i dedikuar më shumë vëmendje trajtimit të vendimeve gjyqësore të dhëna nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese dhe ajo Europiane e të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, nga takimi me studentët, GVJ u informua se edhe forma e të punës në grup për realizimin e një detyre apo projekti, duke përfshirë zhvillimin e elementëve të tillë si administrimi dhe ndarja e punës ndërmjet studentëve, referimi i materialit përfundimtar nga grupi, etj.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Për t’ju përgjigjur diversitetit dhe nevojave të studentëve, këtyre të fundit u mundësohet konsultimi dhe kontakti i vazhdueshëm me personelin akademik dhe koordinatorin e programit. Gjithashtu në çdo lëndë, nga ana e personelit akademik, mundësohet komunikimi me studentët jo vetëm gjatë realizimit të procesit mësimor në auditor, por edhe jashtë auditorit nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike (e-mail, rrjete sociale, kontakte në zyrat e karrierës, këshilli studentor etj.). Në këtë mënyrë, GVJ konstatoi se personeli akademik ka qenë në vazhdimësi i disponueshëm për zhvillimin e konsultimeve për çështje specifike si dhe për t’ju përgjigjur pyetjeve e shqetësimeve individuale të studentëve në lidhje me procesin mësimor. GVJ konstatoi se njësia bazë kishte hartuar një strategji të qartë për zhvillimin e programit të masterit shkencor në “E Drejtë Publike” si dhe udhëzuesin për t’iu përgjigjur nevojave të studentëve. Ev. Nr 5. Strategjia e zhvillimit të programit MSC e drejtë publike; Ev. Nr. 20. Udhëzuesi i studentëve;
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se për përmirësimin e kompetencave didaktike, përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, veprohet në disa drejtime si: (i) financimin e kërkimit shkencor dhe të publikimeve të stafit akademik;

	(ii) infrastrukturës e përshtatshme për mësimdhënie, duke ofruar auditorë të paisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies; (iii) krijimi i oportuniteteve për stafin akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies; (iv) realizimi i trajnimeve, pjesëmarrja në konferenca, aksesit në platforma kombëtare dhe ndërkombëtare, përmirësime të vazhdueshme në pedagogji; (v) përdorimi i modeleve të vlerësimit të harmonizuara me të mësuarit me në qendër studentin;
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me lëndët që mbulojnë dhe se kanë shkallën e kërkuar të kualifikimit për të mbuluar zhvillimin cilësor të mësimin në ciklin e studimeve Master i Shkencave në “E Drejtë Publike”. Gjithashtu nga takimi i zhvilluar me studentët, rezulton se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve teorike shkencore dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit dhe nxit mendimin kritik, punën e pavarur të tyre. Gjithashtu GVJ konstatoi se një marrëdhënie respekti të ndërsjellë ndërmjet studentëve dhe stafit akademik të këtij masteri. Ev. Nr. 12.2. Syllabuset e lëndëve për vitin akademik;
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse në mënyrë periodike vlerëson format dhe metodat e mësimdhënies të ofruara nga stafi akademik i angazhuar në programin master shkencor në “E Drejtë Publike” nëpërmjet një procedure standard dhe të paracaktuar që garanton trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të tij. Gjithashtu, njësia përgjegjëse ndjek një procedurë standard dhe për rekrutimet e reja. GVJ, konstatoi dhe përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve që mundësohet nëpërmjet pyetsorëve. Nëpërmjet këtyre pyetsorëve merret opinioni i studentit në lidhje me strukturimin

Abdullahu



	e lëndëve, cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin e studentit, pedagogun, etj. Ev. Nr. 28. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese; Ev. Nr. 23. Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentet; Ev. Nr. 26. Përmbledhje e procedurës së rekrutimeve;
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ u informua se në shërbim të sigurimit të cilësisë në UMSH është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë dhe Standardeve, i cili, duke bashkërenduar veprimtarinë e tij me organet e tjera drejtuese, si dekanati dhe njësia bazë, vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore si dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit. Procesi i vlerësimit të cilësisë bazohet në procedurë standard dhe periodike dhe mbështetet në analiza statistikore të të dhënave, në konstatime të nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin ndihmës akademik dhe administrativ si dhe studentët. Në këtë kuadër <i>GVJ rekomandon</i> miratimin e një manuali të veçantë e të dejuar për vlerësimin e cilësisë dhe vlerësimit të performancës së personelit akademik. Ngritja dhe rregullorja e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Cilësisë dhe Standardeve (dok shtesë dërguar mbas takimit në institucion;
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstatoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, leksione nga lektorë të ftuar, puna në grup, etj.</i> <i>Personeli akademik është i kualifikuar për të mbuluar në mënyrë cilësore zhvillimin e ciklit të studimit në "E drejtë Publike" si dhe ka qenë në vazhdimësi i disponueshëm për zhvillimin e konsultimeve për çështje specifike si dhe për t'ju përgjigjur shqetësimeve individuale të studentëve në lidhje me procesin mësimor e për këtë qëllim është hartuar udhëzuesi për t'iu përgjigjur nevojave të studentëve.</i>

	Gjithashtu në mënyrë periodike zhvillohen anketime për të vlerësuar performancën e stafit akademik dhe për të rekrutuar staf të ri duke ndjekur procedura standard dhe jo diskriminuese.		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit të masterit shkencor “E Drejtë Publike”, në udhëzuesin e studentit si dhe në syllabuset e lëndëve që detajojnë mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive. Gjithashtu, GVJ konstaton se institucioni ka miratuar dhe udhëzimin mbi mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive Të gjitha aktet e sipërpërmendura u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik si dhe janë lehtësisht të aksesueshme dhe në faqen e internetit të UMSH. Ev. Nr. 8. Rregullore e programit MSC DP; Ev. Nr. 20. Udhëzuesi i studentevë; Ev. Nr. 12.2. Syllabuset e lëndëve; Ev. Nr. 37. Udhëzim mbi procedurat dhe afatet e provimeve;
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Nga takimi me studentët, GVJ konstaton se në programin e studimit master i shkencave në “E Drejtë Publike” studentët informoheshin mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive dhe dijeve, format e kontrollit ishin të ndryshme bazuar në specifikat e secilës lëndë. Ato ishin të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Studentët informoheshin rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit. Gjithashtu, u konstatua se një rol të

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	rëndësishëm ka dhe koordinatori i programit të studimit. Informacionin e nevojshëm studentët e përvetësojnë dhe nga pedagogu i lëndës, si dhe e gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve, ku në varësi të natyrës së lëndës, nga çdo pedagog, në përputhje me rëndësinë që ka aspekti aplikativ përëktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar të ëilat i bëhen të ditura studentit. Sikurse përmendet dhe më lartë, i gjithë informacioni mbi përmbajtjen e programit të studimit gjendej lehtësisht edhe në në faqen zyrtare të UMSH-së.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, me shkrim me gojë dhe i kombinuar. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet tek parimi i kontrollit të vazhdueshëm ku nota përfundimtare është rezultati i arritur falë kombinimit të komponentëve të mëposhtëm: (i) Frekuentimi i lëndës, aktivizimi në seminare, provimi i ndërmejt dhe detyrat e kursit (0%-30/40%; (ii) Provimi përfundimtar (60%-70%); Në takimin e GVJ me studentët u konfirmua që përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e veçanta të aftësive dhe talenteve të tyre, dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor. Gjithashtu, sipas studentëve forma e testimit ishte e përshtatshme për vlerësimin e përgatitjes dhe kompetencave të fituara nga frekuentimi i lëndëve të zhvilluara në programin e masterit shkencor në “E Drejtë Publike”. Ev. Nr. 20. Udhëzuesi i studentëve 2022-2023; Neni 37, Ev. Nr. 6. Rregullor e FDSHH;
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit të masterit shkencor “E Drejtë Publike”, në udhëzuesin e studentit si dhe në syllabuset e lëndëve që detajojnë mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive.</i> <i>Studentët janë të informuar me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve</i>

Handwritten signatures and initials in blue ink.

	nga titullari i lëndës/modulit që në fillim të vitit akademik dhe testimi i njohurive të studentët realizohet në formë dhe mënyra të paracaktuara, me shkrim me gojë dhe i kombinuar sipas akteve të miratuara nga institucioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (syllabuset e lëndëve) si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit, sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë gjithë semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare, detyrave të kursit etj, sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës. Kryesisht kontrollet dhe provimet e ndërmjetme realizoheshin pas mesit të secilit semestër. Ev. Nr. 12.2. Syllabuset e lëndëve për vitin akademik; Ev. Nr. 12.1. Plani mesimor MSC DP.pdf;
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin formë të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se testimi dhe vlerësimi në programin e masterit shkencor “E drejtë publike” është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale (me shkrim, vlerësimin me gojë dhe i kombinuar) me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve). Ev. Nr. 6. Rregullor e FDSHH;
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se vlerësimi përfundim i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin, bazën ligjore në fuqi dhe udhëzimet e nxjerra nga vetë Institucioni për këtë qëllim.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se, vlerësimi i njohurive bëhet sipas

Armen



profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	rregullave të përcaktuara në rregulloren e Departamentit të së Drejtës dhe atë specifike të programit të masterit shkencor në “E Drejtë Publike”. GVJ nga takimi me studentët konstatoi se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve, provimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Ev. Nr. 6. Rregullore e FDSHH; Ev. Nr. 7. Rregullore e departamentit RDD; Ev. Nr. 8, Rregullorja e MSCDP;
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Departamenti i së Drejtës dhe personeli akademik që lekon në masterin shkencor “E Drejtë Publike” bazohen në udhëzimin e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontratës së pedagogut dhe Rregullores së Etikës. Ev. Nr. 45. Kodi i Etikes; Ev. Nr. 19. Udhëzim për përgatitje diplome; Ev. Nr. 20. Udhëzuesi i studentëve;
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas nenit 18 të Rregullores së Departamentit të së Drejtës të zbatueshëm dhe për programin e studimit master shkencor në “E Drejtë Publike” GVJ konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota më e ulët kaluese është 5 e cila arrihet me realizimin e 41-50 pikëve. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve në mënyrë individuale nga sekretaria mësimore në bashkëpunim me pedagogët. Në rastin e provimeve me shkrim, studentët kanë të drejtë të kërkojnë rishikimin e tezës dhe të vlerësimit dhe vetëm mbas kalimit të afatit të ankimit regjistrohen në sistem rezultati përfundimtar. Ev. Nr. 7. Rregullore e departamentit RDD; Neni 22, Ev. Nr. 7 Rregullores së Departamentit të së Drejtës;

Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Neni 23 i Rregullores së Departamentit të së Drejtës përcakton modalitetet e realizimit të ankimit. Studenti dorëzon me shkrim ankimin e rezultatit të provimit pranë sekretarisë mësimore të fakultetit dhe i drejtohet Dekanit, i cili është përgjegjës për verifikimin e situatës duke ngritur komisionin e rivlerësimit. <u>GVJ rekomandon</u> që në rregullore të përcaktohen edhe afate të qarta përsa i përket afatit deri kur studenti mund të ankohet mbasi ka marrë dijeni për notën dhe afatet referuese për verifikimin e situatës pasi kjo do të ndikojë në sigurinë juridike të vlerësimit përfundimtar. Ev. Nr. 7. Rregullore e departamentit RDD;
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në takimin me studentët na konfirmuan që çdo kërkesë, ankim apo pretendim vlerësimi shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit si dhe studentit i grantohet e drejta e përmirësimit të notës së provimit.
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë viti/semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare, detyrave të kursit etj, sipas komponentëve të përcaktuar në sylabusin e lëndës dhe është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale (me shkrim, vlerësimin me gojë dhe i kombinuar) me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve). Testimi bëhet në përputhje me sylabusin dhe Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</i> <i>Nga shqyrtimi i akteve të miratuara nga Institucioni, GVJ rekomandon që në rregullore të përcaktohen edhe afate të qarta përsa i përket afatit deri kur studenti mund të ankohet mbasi ka marrë dijeni për notën dhe afatet referuese për verifikimin e situatës pasi kjo do të ndikojë në sigurinë juridike të vlerësimit përfundimtar.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4


Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë të formimit të përgjithshëm në fushën e së drejtës publike si dhe praktikë profesionale. Kurrikula ka për qëllim përgatitjen e studentëve për të qenë profesionistë të aftë dhe ekspertë në fushën e administratës publike, përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian si dhe të formojë ekspertë për trajtimin e problematikave bashkëkohore në një këndvështrim krahasues në përputhje me risitë dhe sfidat e vendit tonë dhe zhvillimet europiane e ndërkombëtare. Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse. Departamenti ofron shërbime shtese krahas procesit mësimor, te tilla si konsultime apo leksione te hapura. Nga takimet në insitucion GVJ konstaton se stafi akademik përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare dhe shkencore si dhe ka programe të dedikuara për shkëmbimin e studenteve që ndihmojnë në përthithjen e aftësive në fushën e të drejtës publike. Megjithatë nga një analizë e kujdesshme e programit të studimit dhe nga qëllimi që duhet të përndjekë ky program në master shkencor, <u>GVJ rekomandon</u> rishikimin e lëndëve dhe të syllabuseve të ofruara në këtë program me fokus thellimin e dijeve në mënyrë më inçisive dhe të dedikuar ku të adresohen jo vetëm ato tematika që nuk janë trajtuar apo janë trajtuar në mënyrë sipërfaqësore në ciklin e mëparshëm të studimit, si dhe fokusi të jetë në sfidat bashkëkohore që vendi po kalon, për të qenë konkurrues efektiv në treg. Ev. Nr. 5. Strategjia e zhvillimit të programit MSC e drejtë publike;

	Ev. Nr. 12.1. Plani mësimor MSC DP; Ev. 12.2. Syllabuset e lëndeve për vitin akademik; Ev. Nr. 15. Leksione të hapura në DD; Ev. Nr. 42. Marrëveshjet UMSH-Erasmus+; Ev. Nr. 38. Aktivitetet shkencore të UMSH; Lista e mobiliteteve incoming dhe outgoing_Student;
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Lidhur me këtë kriter, referuar dosjes së plotë të programit të studimit të paraqitur në DVV si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se syllabuset e lëndës/modulit paraqesin qartë ne përmbajtjen e tyre: ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse, objektivat, aftësitë dhe kompetencat që priten të fitojë studenti. Këto elemente detajohen në çdo lëndë dhe janë pjesë integrale e objektiveve të përgjithshme të programit. Gjithashtu, GVJ konstatoi se ambientet e UMSH garantonin aksesin në teknologjinë e informacionit dhe përdorimin efektiv të tij në shërbim të qëllimit të përndjekur nga masteri shkencor në “E Drejtë Publike”. <i>Megjithatë, sikurse është përmendur dhe më lartë në këtë raport, është e nevojshme rishikimi dhe përditësimi i literaturës, si dhe përkthimi i syllabuseve në anglisht si një domosdoshmëri jo vetëm në kuadër të ndërkombëtarizimit por dhe për përthithjen e studentëve të huaj në kuadër të shkëmbimit Erasmus.</i> Ev. Nr. 8, Rregullorja e MSCDP; Ev. 12.2. Syllabuset e lëndeve për vitin akademik;
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga shqyrtimi i dosjes në DVV si dhe nga takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti i të së Drejtës zbaton një plan të monitorimit të aftësive profesionale të fituara nga studentët mbi arritjen e objektiveve dhe rezultateve formuese në programin “E Drejtë Publike”. Gjithashtu për përmirësimin e këtij kriteri, <u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti i të së Drejtës të hartojë një analizë vjetore ku të evidentohen qartë arritjen e objektiveve formuese dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe aftësimit shkencor e profesional në programin e studimit “E Drejtë Publike” e cila do të ndihmojë në përmirësimin efektiv të kompetencave dhe aftësive që do të fitojë student në përfundim të çdo lënde.

	Ev. Nr. 29. Plani i monitorimit DD; Ev. Nr. 46. Formulari i vetëvleresimit;
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga shqyrtimi i dosjes në DVV si dhe nga takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë e tyre. Gjatë zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi si dhe i dedikohen analizës së praktikës gjyqësore të gjykatave shqiptare dhe atyre europiane. Gjithashtu, GVJ konstatoi se studentët kanë mundësi të përfitojnë nga klinika e ligjit e cila është funksionale dhe në shërbim të Departamentit të së Drejtës dhe masterit shekncor në "E Drejtë Publike". Plani vjetor i punes 2022-2023 dhe 2023-2024 Klinika Ligjore;
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dosjes në DVV si dhe nga takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i dedikohet nëpërmjet orëve të hapura dhe seminareve trajtimit të çështjeve të rëndësishme si dhe të zhvillimeve më të reja në të drejtën publike. Në këtë kuadër <u>GVJ rekomandon</u> që zhvillimet e reja në fushën e së drejtës publike të prekura dhe jashtë strukturës së programit të studimit të përfshihen në vitin pasardhës akademik në syllabuset e lëndëve të ofruara, e në këtë mënyrë të përkthehen në një përmirësim të kurrikukës dhe përditësimin bashkëkohor të saj.
	Ev. Nr. 15. Leksione të hapura në DD; Ev. Nr. 38. Aktivitetet shkencore të UMSH;
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative,	GVJ konstaton se në Departamenti i së Drejtës, ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore,

studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	hartimin dhe realizimin e projekteve dhe konferencave shkencore në bashkëpunim me studentët apo vizita studimore. GVJ konstatoi gjithashtu se projektet dhe kërkimi shkencor stimulohet edhe nga mbështetja financiare që institucioni ofron për punën shkencore të stafit të tij akademik dhe të studentëve. Në këtë drejtim GVJ nxit Departamentin dhe sfatin akademik të tij të rrisë bashkëpunimet në fushën kërkimore dhe të investojë në mundësinë e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me IAL simotra. Gjithashtu duke u bazuar në organigramën e Institucionit rekomandohet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencave edhe me fakultetet e tjera të UMSH për të ofruar një kurrikul ndërdisiplinare dhe bashkëkohore. Kjo do të impaktonte në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek studentët që të inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Planifikimi i vizitës studimore në Kosove; Plani vjetor i punës për 2023-2024 i Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë, Erasmus+ dhe Projekte; Procedura për rimbursim publikimi shkencor_monografi;
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstatoi se kërkimi shkencor stimulohet edhe nga mbështetja financiare që institucioni ofron për punën shkencore të stafit të tij akademik dhe të studentëve ku këta të fundit ndër të tjera kanë mundësi të përfitojnë nga klinika e ligjit e cila është funksionale dhe në shërbim të Departamentit të së Drejtës dhe masterit shkencor në "E Drejtë Publike".</i> <i>Nga ana tjetër GVJ rekomandon:</i> <i>(i) rishikimin e lëndëve/syllabuseve të ofruara në këtë program me fokus thellimin e dijeve me fokus tek sfidat bashkëkohore që vendi po kalon, për të qenë konkurrues efektiv në treg;</i> <i>(ii) rishikimin dhe përditësimin e literaturës;</i> <i>(iii) përkthimin e syllabuseve në anglisht;</i> <i>(iv) Hartimin e analizës vjetore ku të evidentohen qartë arritjen e objektivave formuese dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe aftësimit shkencor të studentit në përfundim të çdo lënde;</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosjen DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një udhëzim të qartë mbi procedurat dhe afatet e provimeve formuese dhe mbrojtjen e temave të diplomave, i zbatueshëm edhe në ciklin e dytë të studimeve master. Procedura dhe detyrimet përmbyllëse të studenteve janë të përcaktuara edhe në rregulloret e Departamentit të së Drejtës si dhe atë të dedikuar për masterin në “E Drejtë Publike”. Nga konsultimi me studentët u verifikua që ata zotëronin informacion të plotë dhe ky informacion ishte lehtësisht i aksesueshëm jo vetëm pranë zyrave të këtij institucioni por edhe në faqen online të tij. Ndër të tjera udhëzimi përcakton modalitetet dhe afatet e vlerësimit si dhe mundësinë për studentët për konsultim paraprak në klasë me titullarin e lëndës (pika 3 shkronja a), apo procesi i korigjimit të provimit duhet të përfundojë brenda 3 ditëve kalendarike (pika 3, shkronja d). Ev. Nr. 37. Udhëzim mbi procedurat dhe afatet e provimeve 2-22-2023; Ev. Nr 6. Rregullore e FDSHH; Ev. Nr. 7. Rregullore e departamentit RDD; Ev. Nr. 8. Rregullore e programit MSC DP;
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Gjatë vizitës në institucion dhe veçanërisht në takimin e studentët e masterit i shkencave “E Drejtë Publike” u konstatua se si strukturat përgjegjëse ashtu dhe personali akademik të këtij masteri janë të disponueshëm dhe vënë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin dhe udhëzimet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve nga ana e studentëve në mënyrë të informuar dhe koherent me qëllimin e masterit.

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Gjatë vizitës në institucion dhe veçanërisht në takimin e studentët e masterit i shkencave “E Drejtë Publike” u konstatua se komisioni i administrimit të provimit final bazohet në testimin e njohurive të dhënë gjatë gjithë vitit akademik. Kështu në bazë të rregullores së Departamentit të së Drejtës por edhe të syllbauseve të veçantë rregullohen qartë modalitetet e testimit të njohurive të dhëna gjatë vitit akademik dhe kreditet që përfiton studentimi nga dhënia e provimit në një lëndë të caktuar. Ev. Nr. 7. Rregullore e departamentit RDD; Ev. Nr. 12.2. Syllabuset e lëndëve për vitin akademik;
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Gjatë vizitës në institucion dhe veçanërisht në takimin e studentët e masterit shkencor “E Drejtë Publike” u konstatua se këta të fundit asistohen dhe ndihmohen nga pedagogët në përzgjedhjen e temës së diplomës dhe përpunimin e informacioneve të nevojshme që duhet të përfshihen në diplomë si dhe puna e tyre supervizohet nga pedagogu udhëheqës. Gjithashtu studentët në këtë master zhvillojnë lëndën e ‘Metodave të Kërkimit Shkencor’ e cila ndikon dhe ndihmon studentët në kërkimin shkencor dhe garanton cilësi të rezultateve dhe gjetjeve të tyre. Ev. 12.2. Syllabuset e lëndëve për vitin akademik;
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosjen DVV dhe gjatë vizitës në institucion dhe në takimin e studentët e masterit shkencor “E Drejtë Publike” konstatohet se insitucioni falë dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme shtetërore dhe biznese private u mundëson studentëve aksesin dhe përthithjen e informacionit në nevojshëm në shërbim të punës së tyre. Ev. Nr. 42. Marrëveshjet UMSH-Erasmus +;
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes	Bazuar në nenin 20 dhe nenin 24 të Rregullores së programit të studimit MSCDP, studentët në përfundim të provimit përfundimtar vlerësohen me sistemin prej dhjetë notash ku nota

së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	nga e pesë e lartë janë kaluese. Gjithashtu në format e kontrollit të dijeve me shkrim përdoret dhe sistemi i realizimit të pikëve që përkthehet në notë. Ev. Nr. 8. Rregullore e programit MSC DP;
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosjen DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se në përfundimin e këtij cikli studimi, studentët pajisen me Diplomë Master i Shkencave në "E Drejtë Publike" (neni 24 i Rregullores) sipas një modeli standard të diplomës. Ev. Nr. 8. Rregullore e programit MSC DP; Ev. Nr. 39. Model diplome dhe suplementi MSC DP;
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Humane i UMSH nëpërmjet Sekretarisë mësimore ruan kopje të dokumentacionit të studentit pasqyruar në: - Regjistrin themeltar (bazë) të studentëve me të dhënat personale të tyre; - Regjistrin e arritjeve akademike me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit; - Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Këto regjistra mund të konsultohen nga student i cili me kërkesë të tij mund të pajiset me një kopje të dokumentacionit të kërkuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstatoi se Institucioni harton procedurë të posaçme standarde për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike paraprakisht. Strukturat përgjegjëse dhe personali akademik i masterit shkencor "E Drejtë Publike" janë të disponueshëm për të informuar studentët mbi paqartësi të ndryshme të tyre. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas akteve ligjore në fuqi. Gjithashtu, Institucioni ruan në përputhje me</i>

	legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	GVJ nga vizita në institucion konstaton se Institucioni ofron ambientet të dedikuara për procesin mësimor në godinë të cilat janë funksionale, me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik për të zhvilluar veprimtarinë mësimore. Auditorët janë të pajisur me PC, video projektor dhe me internet (ëireless).
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosjen DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton bashkëpunim dhe partneritet me institucione të ndryshme në vend ku studentët mund të realizojnë praktikat e tyre mësimore. Megjithatë GVJ është e mendimit që ka hapsirë dhe mundësi për të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe me institucione të tjera publike duke mbajtur në konsideratë dhe natyrën në të drejtë publike të këtij masteri shkencor dhe nxit institucionin të investohet në këtë drejtim. Gjithashtu, nga takimi me stafin akademik dhe me studentët, GVJ konstaton se Departamenti garanton realizimin e klinikës ligjore dhe përsëri fton institucionin të rrisë përfshirjen e studentëve të këtij masteri në të si dhe vlerësoj se klinka ligjore mund të parashikohet edhe si lëndë me zgjedhje në këtë master

Monica



	duke përmisuar kurrikulën dhe e bërë atë më bashkëkohore sipas modeleve më të mira të vendeve të zhvilluara në këtë drejtim. Ev. Nr. 9. Marrëveshje bashkëpunimi; Ev. Nr. 42. Marrëveshjet UMSH-Erasmus+; Plani vjetor i punës 2022-2023 dhe 2023-2024 Klinika Ligjore;			
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Neni 26 i Rregullores së Departamentit të së Drejtës që gjen zbatim edhe për programin e masterit shkencor objekt i këtij vlerësimi, përcakton modalitetet sesi duhet të zhvillohet praktika profesionale dhe kontrolli nga pedagogu përkatës që duhet të përfundojë me notë. [Ev. Nr. 7]. Gjithashtu dhe plani mësimor i programit të masterit shkencor në “E Drejtë Publike” konstatohet se praktika profesionale zhvillohet semestrin e katërt si veprimtari formuese e kategorisë D dhe vlerësohet me 12 kredite ECTS. Nga ana tjetër, për nga vetë rëndësia që duhet të ketë praktika profesionale, klinika e ligjit si dhe stazhet e zhvilluara gjatë këtij cikli studimi, <u>GVJ rekomandon</u> që në rregulloren e këtij masteri të parashikohen dhe të rregullohen qartë modalitetet dhe procedurat e zhvillimit të praktika profesionale dhe klinika e ligjit si dhe mënyra e rekrutimit të studentëve për tu bërë pjesë e saj. Ev. Nr. 12.1. Plan i mësimor MSC DP; Ev. Nr. 8. Rregullore e programit MSC DP;			
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstaton se Institucioni ofron ambientet të dedikuara për procesin mësimor në godinë të cilat janë funksionale dhe garanton bashkëpunim dhe partneritet me institucione të ndryshme në vend ku studentët mund të realizojnë praktikatat e tyre mësimore.</i> <i>Megjithatë GVJ rekomandon Institucionin të investohet më shumë në rritjen e bashkëpunimit me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu rekomandohet që në rregulloren masterit shkencor “E drejtë publike” të parashikohen dhe të rregullohen qartë modalitetet dhe procedurat e zhvillimit të praktika profesionale dhe klinika e ligjit si dhe mënyra e rekrutimit të studentëve për tu bërë pjesë e saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion konstaton se personeli efektiv, me kontratë dhe ndihmës akademik, i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “E drejtë Publike”, përmbush kriteret ligjore parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Personeli i angazhuar ka kualifikimin e duhur për zhvillimin e programit të studimit, duke mbuluar zhvillimin e tij. Kjo në përgjigje edhe të rekomandimeve të lëna për tu përmbushur më parë. Personeli i angazhuar ka fushë kërkimore në përputhje me natyrën e programit të studimit dhe veçoritë që program paraqet. Personeli është rekrutuar sipas procedurës së parashikuar në Rregulloren e Organizimit të UMSH, neni 39, ku kriteret e posaçme përcaktohen nga njësia bazë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë angazhuar staf akademik për tre vite akademike si më poshtë vijon: 1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë gjithsej, nga të cilët 7 PAE dhe 2 PAK; (78 % PAE / 22 % PAK)



2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë gjithsej, nga të cilët 7 PAE dhe 2 PAK; (78 % PAE / 22 % PAK)
3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë gjithsej, nga të cilët 7 PAE dhe 2 PAK; (78 % PAE / 22 % PAK)

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	2	1	2	1	2	1
Dr/PhD	5	1	5	1	5	1
Msc	-	-	-	-	-	-
Në total	7	2	7	2	7	2

Evidenca nr. 12.3 Cv e stafit akadmeik të programit të studimit MSCDP

Evidenca nr. 10. Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese.

Evidenca nr. 26. Përmbledhje e Procedurës së Rekrutimit të Stafit

Evidenca 36 te dhena tabelore per personelin akademik Mscdp, tabelat 6;

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Personeli akadmeik efektiv i angazhuar në programin e studimit MSCDP, mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Referuar nenit 7 të Rregullores së Departamentit, përgjegjësi i departamentit mban përgjegjësi për ndarjen e ndarkesës mësimore mes personelit akademik, duke respektuar normat e ngarkesës, shkallën e kualifikimit, eksperiencën e personelit akademik dhe numrin e grupeve për disiplinat përkatëse. Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Evidenca 36 te dhena tabelore per personelin akademik Mscdp, tabelat 12), u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për të tre vitet akademike është e njëjtë si më poshtë vijon:

Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
840 orë	705 orë	135 orë	83% / 17 %

	Nga tabela rezulton që për 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. Evidenca nr. 1 Statuti i UMSH Evidenca nr. 7 Rregullore e Departmaentit të së Drejtës Evidenca nr. 14 Përmbledhëse e Tabelave për programin e studimit MSCDP Evidenca nr. 36 Të dhëna tabelore për personelin akadmeik në programin MSCDP, tabelat 12;
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ vëren se institucioni ka garantuar qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, nëpërmjet kontratave të punësimit. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit. Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit gjatë 3 viteve të fundit nuk ka patur ndryshime. Evidenca nr. 36 Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin MSCDP; Evidenca nr. 30 Kontrata e punës tip PAE/PAK; Evidenca nr. 12.3 Cv e stafit akadmeik të programit të studimit MSCDP; Evidenca mbi listën e personelit të rekrutuar;
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe	Procedura e rekrutimit e ndjekur nga institucioni, mbështetet në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura. Punësimi në institucion, realizohet me procedurë konkurimi të hapur, duke garantuar një process transparent, të paanshëm dhe objektiv. Njësitë bazë dhe kryesore, mbështetur në nevojat specifike të programeve të studimit që mbulojnë, përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e kandidaturave në varësi të programit mësimor. Këto kritere i dërgohen Zyrës së Burimeve Njerëzore, përpunohen prej saj dhe pas mratimit nga Rektori, publikohen. Shpallja publikohet për çdo semestër dhe vit akademik në faqen zyrtare të internetit, rrejtet sociale, në shtyp apo television.

përmbajtjen e programit të studimit.	Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga një komision i ngritur nga rektori dhe i kryesuar nga Dekani. Vlerësimi kalon në dy faza, në vlerësimin paraprak të dokumentacionit dhe vlerësimi përmes intervistës. Evidenca nr. 1 Statuti i UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e UMSH; Evidenca nr. 36 Përmbledhje e procedurës së rektorutimit, të stafit akademik;
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Sipas GVJ, institucioni ka vënë në dispozicion mjedise mësimore të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Institucioni ka vënë në dispozicion salla apo mjedise të tjera të mësimdhënies, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për aftësim teorik dhe praktik, sipas objektivave formuese të programit të studimit. Evidenca nr. 24 Relacioni i Godinës;
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimit në institucion, GVJ konstatoi se UMSH mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore. Referuar nenit 38 pika 2 i, të Rregullores së Organizimit UMSH, Zyra e Burimeve Njerëzore përgatit, plotëson dhe ruan dosjet personale të personelit. Të dhënat për programin e studimit mbledhen çdo vit nëpërmjet njësive përgjegjëse për programin e studimit. Të dhënat përfshijnë informacion mbi personelin e angazhuar në programin e studimit, kualifikimin e tyre, ngarkesën mësimore apo angazhimin në aktivitete të tjera. Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP;
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues	Gjatë takimeve në institucion u vërejt se UMSH, për programin MSCDP, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me me institucione arsimore dhe jo arsimore në vend si dhe institucione jashtë vendit. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat

biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	mësimore mundësohen me qëllim aftësimin praktik të studentëve. Kjo marrëdhënie është e rregulluar edhe nëpërmjet udhëzimit për zhvillimin e praktikave dhe formularët e praktikës mësimore. Strukturat përgjegjëse për ndjekjen e praktikës janë njësia bazë, pedagogu këshillues në karrierë dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës. Nëpërmjet Klinikës ligjore, studentëve iu mundësohet edhe praktika profesionale, sipas një plani punë të hartuar nga klinika dhe prezantuar studentëve. Studentët përveç udhëzuesit të studentëve, si një dokument ndihmës dhe orientues i të drejtave dhe detyrimeve të studentit në instiucion, në afrim të diplomimit të tyre, u bëhet me dije dhe u prezantohet Udhëzuesi për Përgatitjen e Diplomës. Evidenca nr. 9 Marrëveshjet e Bashkëpunimit UMSH; Evidenca nr. 42 Marrëveshjet UMSH Erasmus+; Evidenca nr. 11 Udhëzues për praktikat dhe Formularët e praktikës mësimore; Evidenca nr. 19 Udhëzim për përgatitje Diplome; Evidenca nr. 20 Udhëzuesi i Studentëve; Evidenca Plani vjetor i punes 2022-2023 dhe 2023-2024 Klinika Ligjore;
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ konstaton se referuar përmbushjes së detyrimeve sipas marrëveshjeve dhe dakordësisë për të zhvilluar praktikat mësimore, isnitucionet pritëse angazhohen në mënyrë specifike për të ndihmuar studentët në përmbushjen e detyrimeve dhe marrin pjesë në procesin e vlerësimit të praktikës. Studenti mbikqyret në ndjekjen dhe realizimin rigoroz të praktikës dhe pajiset me formularin përkatës të vlerësimit. Evidenca nr. 11 Udhëzues për praktikat dhe Formularët e praktikës mësimore;
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar për realizimin e programit të studimit MSCDP,</i>

	<i>përmbush kriteret ligjore në fuqi, duke patur nivelin e duhur të kualifikimit, mbulimin e ngarkesës mësimore.</i> <i>Institucioni dëshmon qëndrueshmëri të personelit të angazhuar. Gjithashtu procedura e ndjekur për rekrutimin realizohet me procedurë konkurimi të hapur, duke garantuar një process transparent, të paanshëm dhe objektiv, në përgjigje të nevojave specifike të njësisë. Të dhënat në lidhje me personelin mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</i> <i>UMSH u mundëson studentëve të programit të studimit MSCDP, zhvillimin e praktikave mësimore, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit si dhe i informon dhe mbikqyr realizimin e tyre, sipas udhëzuesve të posaçëm.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Pas vizitës në institucion, GVJ vëren se UMSH siguron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Këto mjediset janë vënë në dispozicion bazuar në numrin e studentëve dhe grupeve mësimore. Në referim të studentëve të regjistruar në program studimi dhe programit të lëndës, oraret dhe sallat e leksioneve dhe seminareve afishohen. UMSH plotëson normativën e ndriçimit natyral, siguron ngrohje dhe ftohje në të gjithë godinën, si dhe përmbush detyrimet për systemin e mbrojtjes kundër zjarrit. Evidenca nr.24 Relacioni i Godinës;
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me	Mjediset mësimore të vëna në dispozicion për programin e studimit MSDP, janë të pajisura me mjete elektrike dhe teknologjike për të mundësuar një proces teorik e praktik sipas metodave metodologjike bashkëkohore të mësimdhënies e

Procedura

[Signature]

mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	mësimnxënies. UMSH ofron një ambient të posaçëm për bibliotekën dhe mundësinë për të aksesuar materiale online. Një kujdes i posaçëm i mundësohet studentëve me aftësi ndryshe, ku në dispozicion të tyre janë vënë rrampa dhe ashensorë apo sinjalistikën e nevojshme, që mundësojnë lëvizjen e lirë e pa problem të tyre. Evidenca nr.24 Relacioni i Godinës; Evidenca nr. 18 Rregullore për studentët me aftësi ndryshe;
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në UMSH, ambientet e dedikura për procesin mësimor, plotësojnë kushtet për mësimdhënie. Ato janë të pajisura me infrastrukturën e përshtatshme teknologjike, për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe objektivave formuese të programit. Laboratori i Teknologjisë së Informacionit, ka poste të pajisura me teknologjinë e nevojshme, dhe mund të shfrytëzohen nga studentët edhe jashtë orarit të mësimin, për realizimin e detyrave praktike. Evidenca nr.24 Relacioni i Godinës;
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	UMSH disponon laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me kompjutera në të cilat janë instaluar programet bazike në ëindoës 7. Laboratori është një investim i projektit Erasmus+ “University to Society Innomediaries in Albania: Co-production of knowledge and research that matters/ U-SIA”, financuar nga Bashkimi Evropian. Këto ambiente janë në dispozicion të të gjithë studentëve, për tu përdorur gjatë orarit mësimor por edhe jashtë tij. https://usia.al/u-sia-laboratory-inauguration-at-the-mediterranean-university-of-albania-mua/
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet	Gjatë takimeve në institucion, u konstatua se UMSH, për programin MSCDP, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me me institucione arsimore dhe jo arsimore në vend si dhe institucione jashtë vendit. Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikant mësimore mundësohen me qëllim aftësimin praktik të studentëve. Kjo marrëdhënie është e rregulluar edhe nëpërmjet

marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	udhëzimit për zhvillimin e praktikave dhe formularët e praktikës mësimore. Strukturat përgjegjëse për ndjekjen e praktikës janë njësia bazë, pedagogu këshillues në karrierë dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës. Nëpërmjet Klinikës ligjore, studentëve iu mundësohet edhe praktika profesionale, sipas një plani punë të hartuar nga klinika dhe prezantuar studentëve. Evidenca nr. 9 Marrëveshjet e Bashkëpunimit UMSH; Evidenca nr. 11 Udhëzues për praktikat dhe Formularët e praktikës mësimore;			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH ka vënë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies për programin e studimit MSCDP. Godina përmbush normativën e sipërfaqes dhe vëllimin e shfrytëzueshëm për studentët, plotëson normativat e ndriçimit natyral, ajrosjes, ngrohjes apo ftohjes në të gjithë godinën dhe siguron systemin e mbrojtjes kundër zjarrit. Institucioni ka krijuar lehtësira infrastrukturore për studentët me aftësi ndryshe. Labororet e teknologjisë së informacionit përdoren jo vetëm gjatë procesit mësimor por edhe jashtë tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të	Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re se biblioteka e UMSH është e pajisur me tekste universitare, libra, revista shkencore apo botime të tjera në gjuhë shqipe e të huaj, të lidhura me të

studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	gjitha programet e studimit që ofrohen në institucion. Biblioteka ofrohen edhe akses online të materialeve të ndryshme. Referuar dokumentacionit të paraqitur, fondi i bibliotekës i vënë në dispozicion për programin e studimit MSCDP, është i vakët. Literatura përbëhet kryesisht nga tekste të vetë personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit. Gjithashtu, gjatë takimit të zhvilluar me personeli akademik ata u shprehën se sipas rastit, gjatë orës mësimore, i vënë në dispozicion studentëve literaturë, jurisprudencë dhe artikuj të ndryshëm të përditësuar. Për sa më lart, <i>GVJ rekomandon që fondi i bibliotekës të pasurohet me literaturë kombëtare dhe ndërkombëtare që i përgjigjet 5 viteve të fundit. Përditësimi të jetë periodik dhe ti përgjigjet ndryshimeve në legjislacion dhe në praktikën gjyqësore sipas rastit. Gjithashtu, edhe silabuset të përditësohen me literaturën përkatëse.</i> Evidenca nr. 24 Relacioni i Godinës; Pasurimi i Fondit të Bibliotekës; Dokumentacioni i abonimit ne bibliotekat digjitale;
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ konstaton se literatura e vënë në dispozicion për programin e studimit, i korresponдон një literature jo të viteve të fundit. Institucioni nxit dhe mbështet publikimin e teksteve universitare për tu përdorur nga studentët, por kjo i përgjigjet vetëm disa lëndëve specifike dhe teksteve në formën e monografive. Për studentët dhe personelin është vënë në dispozicion biblioteka online. Gjithashtu institucioni ka një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës, sipas kërkesave të njësisë bazë, para fillimit të vitit akademik. Pasurimi i Fondit të Bibliotekës; Dokumentacioni i abonimit ne bibliotekat digjitale; Procedura per rimbursim publikimi shkencor monografi;
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e	Gjatë vizitës në insittucion, GVJ vizitoi dhe ambientet e bibliotekës, ku u vërejt se kjo e fundit është një ambient i dedikuar për studentët, ndodhur në katin përdhes të godinës. Ambienti është i organizuar në tavolin apuna, tavolina me pc dhe

shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	raftet e librave. Biblioteka qëndronte e hapur për studentët dhe jashtë orarit të procesit mësimor dhe studentët asistohen nga një personel i dedikuar. Ambienti është i bollshëm, i ajrosur dhe i ndriçuar. Evidenca nr. 24 Relacioni i Godinës;
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e institucionit është në dispozicion të gjithë programeve të studimit që ofrohen. GVJ konfirmon se biblioteka është e pajisur me fond fizik (referuar evidencës nr.24, janë 1500 tituj) si tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, kryesisht në gjuhën shqipe. Aksesit në artikuj e revista shkencore, realizohet përmes bibliotekës elektronike, sipas adresave të dedikuara institucionale, të aksesuara përmes faqes zyrtare https://biblioteka.umsh.edu.al. Institucioni është pjesë e Electronic Edëard Elgar for Libraries, për përdorimin e Edëard Elgar Publishing si dhe ka qenë anëtare e COBISS me të drejta të plota deri më 01.02.2022. Pjesë e fondit të bibliotekës, janë edhe punimet e diplomave të studentëve apo proceeding books të konferencave të organizuara. Evidenca nr. 24 Relacioni i Godinës; https://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php https://al.cobiss.net/ https://ëëë.elgaronline
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Aktualisht, fondi i literaturës elektronike të institucionit është instaluar në kompjuterat në institucion, të cilët studentët mund ti përdorin në bibliotekë, në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë. Por, departamenti i informatikës është angazhuar për krijimin e mundësive/programeve të aksesimit të këtij fondi edhe jashtë institucionit. Ndërkohë, aksesit në artikuj e revista shkencore online, realizohet përmes bibliotekës elektronike, sipas adresave të dedikuara institucionale, të aksesuara përmes faqes zyrtare https://biblioteka.umsh.edu.al. Institucioni është pjesë e Electronic Edëard Elgar for Libraries, për përdorimin e Edëard Elgar Publishing si dhe ka qenë anëtare e COBISS me të drejta të plota deri më 01.02.2022.

	Evidenca nr. 24 Relacioni i Godinës; https://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php https://al.cobiss.net/ https://ccc.elgaronline;
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion u vërejt se ambientet e bibliotekës janë të pajisur me kompjutera dhe programe kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin e tyre. Studentët ambientet e bibliotekës i shfrytësojnë edhe si salla studimit, duke qenë se janë në dispozicion të të gjithë studentëve të insitucionit dhe asistohen nga personel i dedikuar. Evidenca nr. 24 Relacioni i Godinës;
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga takimi me studentët si dhe gjatë vizitës në institucion u konstatua se biblioteka është në dispozicion të studentëve, sipas orareve të koordinuara të zhvillimit të procesit mësimor dhe janë të afishuara.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë	Nga takimet e zhvilluara në insitucion dhe gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës, u vu re se duhet të ketë një koordinim dhe bashkëpunim për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës, i cili jo vetëm duhet ti përgjigjet një literature të përditësuar të viteve të fundit, por dhe të ketë një numër kopjesh të mjaftueshme për programin e studimit. Në aktet e brendshme të institucionit, studentët informohen me të drejtat dhe detyrimet e tyre mbi aksesin në bibliotekë. Përmes Njësisë së sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, realizohen pyetësorë të ndryshëm të cilët kanë në fokus raportimin e cilësisë së shërbimeve mbështetëse në institucion, përfshirë edhe bibliotekën. Këto të dhëna bejnë pjesë në raportin vjetor të vlerësimit të institucionit. Evidenca nr. 20 Udhëzuesi i studentetit;

qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Evidenca nr. 31 Procedura e punës me fokus grupet; Evidenca nr. 16 Rregullore e Organizimit dhe Punës së NJSBCZHK;			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit bibliotekën, si një ambient të dedikuar në katin përdhës të godinës, me një sipërfaqe të konsiderueshme, të ajrosur dhe ndriçuar, të pajisur me tavolina pune, kompjutera dhe rafta librash. Biblioteka përbëhet nga fond fizik dhe elektronik si dhe nga aksesit në burime të jashtme, në formën e bibliotekës dixhitale. Biblioteka aksesohet e koordinuar me oraret e procesit mësimor dhe ka një personel të dedikuar.</i> <i>GVJ konstaton se literatura e vënë në dispozicion për programin e studimit është e papërditësuar si dhe në numër të pakët të titujve dhe kopjeve. Ndërkohë që si praktikë e mirë, veçohet fakti së institucioni mbështet publikimin e teksteve, në formën e monografive, që shërbejnë edhe si tekste universitare për studentët. Literatura e lëndës pasurohet në orën mësimore me artikuj dhe vendime të jurisprudence sipas rastit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e	GVJ vëren se në institucion është ngritur dhe funksionon sistemi i Menaxhimit të Studentëve (SMS) i cili shërben për procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe ndërveprimin mes studentëve dhe personelit akademik nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Studentët dhe personeli asistohen nga guida dhe manual të dedikuara për aksesin dhe përdorimin e sistemit.



tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nëpërmjet sistemit, personeli akademik menaxhon proceset që lidhen me krijimin dhe menaxhimin e grupeve mësimore, hedhjen e notave, kontrollin dhe menaxhimin e kërkesave për përmirësim nore, kontrollin dhe menaxhimin e kërkesave për lëndë extra kurrikulare, përditësimin e planit mësimor për program studimi. Evidenca nr. 40 Manual për përdorimin e SMS;
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Pas vizitës dhe takimeve të kryera në institucion, u vu re se sistemi i brendshëm i menaxhimit dhe administrimit të informacionit, realizohet sipas strukturave të përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit. Respektivisht, informacioni që lidhet me dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndahet midis njësisë bazë dhe zyrës së burimeve njerëzore, e cila është ëprgjegjëse për ruajtjen dhe përditësimin e dosjes së personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative të angazhuar. Në nivel njësie kryesore, përmes koordinаторit të fakultetit, realizohet mbledhja, përpunimi dhe administrimi i dokumentacionit që lidhet me veprimtarinë e tij. Në të dyja këto nivele, dokumentacioni ruhet në format hard copy dhe elektronik. Për procesin mësimor, asiston në menaxhimin dhe administrimin e informacionit sekretaria mësimore dhe procesi mësimor akademik mënxhohet dhe administrohet përmes sistemit SMS. Evidenca nr. 1 Statuti UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 32 Manuali i përdorimit të platformave elektronike;
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni, sistemin e menaxhimit elektronik e ka të organizuar në dy nivele. Së pari, nivelin e personelit (ku përfshin personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ) dhe së dyti niveli i studentit. Niveli i personelit mundëson administrimin siguron akses të dedikuar në informacione që lidhen me procesin mësimor dhe dokumentet e gjeneruara respektive, si prsh procesverbalet e vlerësimit. Ndërkohë për studentët mundësohet akses në materialet e leksioneve, literatures dhe në të gjitha zërat e programit të studimit, informacion që lidhet me lëndët, kreditet, mënyrën e vlerësimit etj. Nëpërmjet sistemit studentët

Handwritten signature

Handwritten signature

	informohen mbi aktet e brendshme të institucionit, njoftime për aktivitete apo informacione të tjera që lidhen me programin e studimit. Evidenca nr. 32 Manuali i përdorimit të platformave elektronike;
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Referuar takimeve të zhvilluara në institucion, mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit elektronik, vërehet se është kryesisht një komunikim aktiv me qëllim shkëmbimin e informacionit, mes dy niveleve të përfshirjes së tij, personelit dhe studentëve. Efikasiteti i sistemit të menaxhimit konsiston në mundësinë e aksesit të informacionit në çdo kohë apo vend. Në ndihmë të sistemit në institucion ofrohen dhe kanale komunikimi interaktiv në kohë reale siç janë G-suite apo Zoom Cloud Meetings. Evidenca nr. 32 Manuali i përdorimit të platformave elektronike;
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit elektronik por dhe ai jo elektronik në institucion, ndihmon në monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik të personelit përgjegjës, për element që lidhen me procesin mësimor, kërkimin shkencor etj. Gjithashtu mundëson prodhimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore që lidhen me performancën e studentit apo frekuentimin. Gjithashtu të dhënat e mbledhura mundësojnë gjenerimin e raporteve vjetore institucionale që u vihen në dispozicion organeve drejtuese, për procese strategjike të institucionit apo për procese të ndryshme institucionale.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni ka të publikuar në faqen ëeb, të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit MSCDP, duke përfshirë të dhëna që lidhen me ndarjen vjetore të lëndëve, kreditet si dhe listën e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, sëbashku me kontaktet institucionale respektive. Informacionet e sipërpërmendura gjenden edhe në formën e broshurave përmbledhëse. Faqja ëeb e institucionit ofrohet në gjuhën shqipe me mundësinë e përkthimit të saj edhe në gjuhën angleze. https://ëëë.umsh.edu.al/;

Komiteti

[Signature]

Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH ka krijuar një sistem të brendshëm funksional të mënazhimit, administrimit dhe publikimit të informacionit. Kjo është realizuar përmes akteve të brendshme të institucionit sipas të cilave janë përshkruar detyrat dhe funksionet respektive përsa I përket mënyrës së administrimit të informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik apo financiar në nivel ishtitucioni, njësie kryesor edhe njësie bazë. Gjithashtu, institucioni ka ngritur një platformë elektronike SMS, në dispozicion të personelit dhe studentëve, si një formë e mbajtjes, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave që lidhen me procesin mësimor, kryesisht me lëndën, leksionet, prezencën, vlerësimet etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Gjatë vizitës në ishtitucion dhe takimeve të realizuara, GVJ konstaton se institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar të planifikimit dhe përdorimit të burimeve financiare. Planifikimi konsiston tek përcaktimi i nevojave financiare të njësisë bazë për realizimin e programit të studimit e përfundon tæk miratimi i tyre nga Bordi i Administrimit. Administratori i institucionit harton çdo vit projekt buxhetin sipas kërkesave të njësisë përbërëse dhe propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, për tu marrë vendimi në vijim nga Bordi i Adminsitrimmit. Ndryshimet e mundshme të buxhetit të institucionit bëhen sipas procedurave të parashikuara në aktet e brendshme. Evidenca nr.1 Statuti UMSH;

Komiti



	Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 17 Tabela e të dhënave Financiare;
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në	GVJ vëren se përmes administratorit të njësisë kryesore, realizohet planifikimi financiar i njësisë bazë për ofrimin e programit të studimit, sipas nevojave dhe kërkesave të kësaj të fundit. Ky raportim i dërgohet në vijim Administratorit të institucionit, për të realizuar planifikimin e buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm. Institucioni nuk ka një praktikë të posaçme të realizimit të një planifikimi të tillë, por rezulton që kjo të jetë realizuar, referuar edhe Tabelave të të dhënave financiare. Evidenca nr.1 Statuti UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 17 Tabela e të dhënave Financiare;
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ konstaton se në zbatim të politikës së transparencës në përdorimin e burimeve financiare, institucioni ka ngritur një strukturë të posaçme dedikuar auditimit, strukturë e cila është përgjegjëse për kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Gjithashtu, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, institucioni realizon një auditim të jashtëm të pavarur dhe kontrollin e pasqyrave financiare. Evidenca nr.1 Statuti UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 17 Tabela e të dhënave Financiare;
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ gjen se Zyra e Financës dhe Kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Ajo ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, deri në nivel njësie bazë përgjegjëse për programin e studimit MSCDP.
	Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH;
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e	Pas vizitës në institucion dhe takimeve të zhvilluar, GVJ vëren se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit MSCDP. Institucioni ka

programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	kapacitete infrastrukturore dhe burime njerëzore të mjaftueshme për realizimin e tij. Pasqyrat financiare pasqyrojnë qëndrueshmërinë dhe gjendjen financiare të institucionit për garantimin e vazhdimin dhe ecurinë e programit në të ardhmen. Evidenca nr. 17 Tabela e të dhënave Financiare;			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, përmes strukturave të tij realizon planifikimin financiar të njësisë kryesore, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit. Planifikimi realizohet përmes identifikimit të nevojave, të cilat më pas bëhen pjesë e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të institucionit. Nevojat përfshijnë ato infrastrukturore, kërkimore shkencore apo didaktike.</i> <i>Institucioni ka ngritur struktura efektive të auditimit të brendshëm si dhe realizon auditimin e jashtëm dhe publikimin e pasqyrave financiare. Këto të fundit, reflektojnë qëndrueshmërinë dhe gjendjen financiare të institucionit, si një garanci për vazhdimin e programit në të ardhmen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ vëren se fereruar Planit Strategjik të Zhvillimit të institucionit, është hartuar një politikë e mirëmenduar e organizimit të ciklit të plotë akademik të studentëve nga hyrja deri në dalje. Institucioni ka hartuar një paketë aktesh të brendshme të cilat normojnë dhe rregullojnë procesin e pranimin, ndjekjes dhe diplomimit të studentëve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Studentët kanë mundësi të aksesojnë këtë bazë ligjore, në kohën që ndjekin studimet pranë këtij institucioni. Evidenca nr. 1 Statuti UMSH; Evidencan nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 4 Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH; Evidenca nr. 5 Strategjia e Zhvillimit të Programit MSC e Drejtë Publike; Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP;
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ vëren se sipas akteve të brendshme të institucionit, janë parashikuar politika dhe procedura që garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student në programin e studimit MSCDP. Këtë program studimi mund ta ndjekin studentë nga universitetet shqiptare (publike apo private) si dhe student nga vëndet shqipfolëse, të cilët zotërojnë sëpaku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. Në përfundim të këtij cikli studimesh, studentët kanë të drejtë të diplomohen, me anë të temës së diplomës dhe pajisen me diplomë Master i Shkencave në “E Drejtë Publike”. Evidenca nr. 1 Statuti UMSH;
	Evidenca nr. 5 Strategjia e Zhvillimit të Programit MSC e Drejtë Publike; Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP;



Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ konstaton se pranimet në ciklin e dytë të studimeve bëhen në përputhje me specifikat e programit të studimit, nevojat e tregut, mundësitë akademike dhe infrastrukturore të institucionit. Institucioni shpall kriteret specifike të pranimit në programin e studimit, ku mund ta ndjekin studentë nga universitetet shqiptare (publike apo private) si dhe student nga vendet shqipfolëse, të cilët zotërojnë sëpaku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. Kriter pranimi është njohja nga kandidati i një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian. Në nenin 12 të Rregullores së Programit MSCDP, janë parashikuar dhe rastet e pranimit të studentëve me apo pa plotësim kreditesh. Evidenca nr. 6 Rregullore e FDSHH; Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP;
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Referuar akteve të brendshme të institucionit, janë parashikuar kriteret dhe procedura e transferimit, ku në rastin e programit të studimit MSCDP, studentët që dëshirojnë të transferohen nga një institucion tjetër në UMSH, i paraqet një kërkesë dekanit të FDSHH, duke i bashkëlidhur dhe dokumentat e nevojshme si vërtetim çregjistrimi, listën e provimeve të dhëna sëbashku me notat dhe kreditet përkatëse si dhe programet e lëndëve të ndjekura. Transferimi i studimeve mund të bëhet para fillimit të vitit akademik. Për vlerësimin e aplikimeve, ngrihet Komisioni i Transferimit me vendim të Senatit Akademik, ku marrin pjesë pedagogë nga personeli akademik efektiv i njësisë kryesore. Kriteret e pranimit mbi të cilat bazohet komisioni në transferimin e studimeve propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Rektori. Evidenca nr. 6 Rregullore e FDSHH; Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP;
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua në lidhje me fushatat e informimit të publikut dhe kandidatëve potencialë për studentë. Kjo realizohej përmes Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, e cila koordinon punën për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme promovuese apo panairë. Institucioni ka prodhuar dhe vë në dispozicion të të

veçanta të programit të studimit.	interesuarve broshura informuese në formatin hard copy dhe elektronike. Evidenca nr. 33 Broshura të programeve Master; Evidenca nr. 35 Rregullore ZKSK; Plani vjetor i punës 2022-2023 dhe 2023-2024 i Zyrës për Këshillimin e Karrierës;
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstaton se institucioni njet një procedurë të dedikuar për përzgjedhjen e kandidatëve student në aftësi të veçanta. Për studentët me aftësi ndryshe institucioni mundëson përdorimin e mjediseve përmes marrjes së masave specifike si materiale të aksesueshme të përshtatshme, kurrikula gjithëpërfshirëse, informacionit dhe komunikimit. Personeli akademik, ndihmës akademik dhe andministrativ është i angazhuar për tu dhënë ndihmën dhe kujdesin e nevojshëm studentëve me aftësi ndryshe, për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Institucioni ka hartuar dhe një rregullore të posaçme për të rregulluar statusin e tyre. Evidenca nr. 18 Rregullore për studentet me aftësi ndryshe;
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ vlerëson se institucioni shpall kriteret specifike të pranimi në programin e studimit, student nga shtetet e tjera shqipfolëse, të cilët zotërojnë sëpaku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. Kriter pranimi është njohja nga kandidati i një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian. Në nenin 12 të Rregullores së Programit MSCDP, janë parashikuar dhe rastet e pranimi të studentëve me apo pa plotësim kreditesh. Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP;
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ pas takimeve të zhvilluara në institucion vë re se insitucioni ofron mundësi të pajisjes së studentëve me bursa apo reduktim të tarifave. Detajet e përfitimit, kategoritë dhe masat e përfitimit parashikohen në akte të posaçme. Evidenca nr. 51 Programi i Bursave;

Kouurco

[Signature]


Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, ka hartuar dhe zbaton politika të mirëpërcaktuara në aktet e brendshme, për procedurat e pranimit, përzgjedhjes, transferimin njohejn dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Këto politika fillojnë që në momentin e regjistrimit në institucion e përfundojnë pasi student diplomohet. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve publikohen në faqen ëeb të institucionit dhe janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku dhe të interesuarit. Institucioni përmes fushatave informuese apo pjesëmarrjes në panairë prezanton ofertën akademike. Një praktikë shumë e vlerësuar, është politika që ndiqet për studentët me aftësi ndryshe. Institucioni nxit dhe mbështet studentët me anë të bursave dhe reduktimin e tarifave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ vëren se institucioni ofron një informacion të plotë dhe të hollësishëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik. Në aktet e brendshme është parashikaur se programi i studimit MSCDP realizohet me ndjekje mësimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vjet, ku në përfundit të tij studenti plotëson 120 kredite. Format kryesore të punës mësimore janë leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat mësimore, detyrat, projektet dhe provimet. Orët mësimore janë me frekuentim të detyrueshëm. Shkalla e përvetësimit të dijeve vlerësohet me një system prej 10 notash, ku nota 5 e lart, konsiderohen nota kaluese. Studenti ka të drejtë të kalojë në vitin e dytë, vetëm kur ai ka fituar të paktën 30 ETCS në vitin e parë. Nëse student nuk plotëson detyrimet akademike të përcaktuara në programin e lëndës, ai nuk pranohet në provim. Ndër të tjera, student ka të drejtë të

Ascal



	zgjasë afatin e studimeve mbi kohën normale, por jo më shumë së dyfishi i kohëzgjatjes respektive. Në përfundim të këtij cikli studimesh, studentët kanë të drejtë të diplomohen, me anë të temës së diplomës dhe pajisen me diplomë Master i Shkencave në “E Drejtë Publike”. Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP; Evidenca nr. 6 Rregullore e FDSHH;
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstaton se FDSHH pranon transferime të studentëve nga universitet e tjera dhe lejon transferimin e studentëve të tij në universitete të tjera. Studentët kanë të drejtë të transferojnë studimet e tyre përmes sistemit të krediteve ECTS dhe vetëm para fillimit të viti akademik studentët që dëshiron të transferohet nga një institucion tjetër në UMSH, i paraqet një kërkesë dekanit të FDSHH, duke i bashkëlidhur dhe dokumentat e nevojshme si vërtetim çregjistrimi, listën e provimeve të dhëna sëbashku me notat dhe kreditet përkatëse si dhe programet e lëndëve të ndjekura. Për vlerësimin e aplikimeve, ngrihet Komisioni i Transferimit me vendim të Senatit Akademik, ku marrin pjesë pedagogë nga personeli akademik efektiv i njësisë kryesore. Kriteret e pranimit mbi të cilat bazohet komisioni në transferimin e studimeve propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Rektori. Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP; Evidenca nr. 6 Rregullore e FDSHH; Evidenca nr. 20 Udhëzuesi i Studentit;
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Pas takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ vlerëson se institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Kjo procedurë realizohet në fillim të vitit akademik, ku secili personel akademik shpjegon përmes silabusit të lëndës, këto kritere. Gjithashtu procesi i informimit shtrihet gjatë vitit akademik duke u interesuar pranë lektorit përkatës apo edhe sekretarisë mësimore. Përmbajtja e silabusit të lëndës ndodhet edhe në sistemin SMS. Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP;

	Evidenca nr. 6 Rregullore e FDSHH; Evidenca nr. 12.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023;
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton një udhëzues të dedikuar për përgatitjen e punimit të diplomës, për ciklin e dytë. Udhëzuesi përmban shpjegime në lidhje me zgjedhjen dhe miratimin e temës, mënyrën e zhvillimit të udhëheqjes së punimit të diplomës, zhvillimin e seancave këshillimore, dhe mënyrën e organizimit të punimit të diplomës. Procesi i fundit është vlerësimi u punimit nga komisioni i vlerësimit dhe kriteret mbi ku bazohen. Evidenca nr. 19 Udhëzim për përgatitje diplome;
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ vlerëson se institucioni realizon para fillimit të e institucioni realizon para fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike informimin e të interesuarve për programin e studimit. Kjo realizohet përmes Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, e cila koordinon punën për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme promovuese apo panaire. Institucioni ka prodhuar dhe vë në dispozicion të të interesuarve broshura informuese në formatin hard copy dhe elektronike. Evidenca nr. 33 Broshura të programeve Master; Evidenca nr. 35 Rregullore ZKSK; Plani vjetor i punës 2022-2023 dhe 2023-2024 i Zyrës për Këshillimin e Karrierës;
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve deri në diplomimin e tyre. Për sa më lart institucioni ka hartuar një paketë të plotë të akteve të brendshme që shpjegojnë dhe detajojnë këto marrëdhënie. Aktet u bëhen me dijeni dhe janë të aksesueshme nga studentët.</i> <i>Institucioni i arsimit të lartë organizon dhe merr pjesë në formate promovimi të programeve të studimit që ofron, për tia</i>

Konkluzioni




	bërë me dijeni studentëve potencialë dhe komunitetit. Institucioni ka detajuar kriteret e prnaimit si dhe procedurat e transferimit të studimeve. Për studentët, vihet në dispozicion një udhëzues për punimin e diplomës, i cili orienton dhe strukturon studentët drejtë finalizimit më sukses të saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mu;ndësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë takimit me studentët, GVJ vlerësoi se ata informoheshin në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, studentët informohen dhe u prezantohet silabusi nga lektori përgjegjës. Gjithashtu procesi i informimit shtrihet gjatë vitit akademik duke u interesuar pranë lektorit përkatës apo edhe sekretarisë mësimore. Përmbajtja e silabusit të lëndës ndodhet edhe në sistemin SMS. Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP; Evidenca nr. 6 Rregullore e FDSHH; Evidenca nr. 12.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023;
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ vlerësn se studentëve, institucioni i vë në dispozicion dokumentacion dhe udhëzues të posaçëm për lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Përmes sistemit të menaxhimit SMS student ka akses në silausin e lëndës dhe elementët e tij përbërës. Gjithashtu paketa e akteve të brendshme të institucionit i bëhet me dijeni dhe studentët mund të kenë një kopje të tyre. Në fillim të vitit akademik studentët pajisen me udhëzuesi e studentit, njihen me rregulloret e njësisë kryesore, bazë dhe të programit të studimit. Gjithashtu, gjatë vitit të dytë akademik studentët njihen me manualin e diplomës. Studentët



	gjatë viti akademik asistohen nga strukturat akademike dhe administrative si Sekretaria Mësimore apo Zyra e Këshillimi të Studentëve dhe Karrierës. Evidenca nr. 8 Rregullore e Programit MSCDP; Evidenca nr. 6 Rregullore e FDSHH; Evidenca nr. 20 Udhëzuesi i Studentit; Evidenca nr. 35 Rregullore ZKSK;
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Referuar akteve të brendshme, GVJ evidenton se Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës drejton dhe mbështet studentët gjatë procesit të formimit dhe i orienton e këshillon ata me kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjeve. Në orientimin drejtë tregut të punës, studentët asistohen edhe gjatë zhvillimit të praktikave. Kjo zyrë orienton veprimtarinë e saj, sipas një kalendari vjetor pune. Studentëve të programit të studimit MSCDP, u oftohet dhe angazhim pranë Klinkës Ligjore. Evidenca nr. 35 Rregullore ZKSK; Plani vjetor i punës 2022-2023 dhe 2023-2024 i Zyrës për Këshillimin e Karrierës; Plani vjetor i punës 2022-2023 dhe 2023-2024 Klinika Ligjore;
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ vëren se institucioni iu vë studentëve në dispozicion një informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin e procesit mësimor. Orari gjendet në sistemin e menaxhimit të informacionit SMS por edhe i afishuar në ambiente të veçanta. Për zhvillimin e procesit mësimor, studentëve iu vihen në dispozicion salla të leksioneve, seminareve, ambientet e bibliotekës. Evidenca nr. 20 Udhëzuesi i Studentit; Evidenca nr. 24 Relacioni i godinës; Evidenca nr. 27. Kalendari akademik;
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes	GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit të informacionit SMS shërben si një urë lidhëse dhe komunikimi eficient me studentit dhe personelit të institucionit. Përmes tij mundësohet

sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	informacion i detajuar për programin e studimit si dhe informacione të ndryshme për kurrikulën, silabuset apo njoftime. Sistemi është i aksesueshëm në distancë. Evidenca nr. 45 Udhëzues për përdorimin e SMS;			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të hollësishëm mbi objektivat formuese, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit MSCDP. Studentëve iu vihen në dispozicion manual dhe udhëzues të posaçëm. Përmes strukturave administrative, studentët informohen mbi mundësitë e punësimit dhe orientimin në tregun e punës. Sistemi i menaxhimit të informacionit SMS, i mundëson aksesin në distancë të studentëve dhe konsiderot si një mjet ndërlidhës mes personeleve dhe studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstatoi se Sekretaria Mësimore e Fakultetit mban dhe përpunon të dhëna statistikore vjetore lidhur me numrin e studentëve në programin e studimit MSCDP si dhe të dhëna statistikore lidhur me studentët e diplomuar. Evidenca nr. 48 Statistika mbi numrin e studentëve të diplomuar MSC DP; Evidenca nr. 2 Rregullore e organizimit UMSH;
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e	Përmes sekretarisë mësimore, institucioni siguron të këtë disponim mbi statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqjet nga program, largimet, pezullimet etj. Sekretaria mësimore disponon dhe

Arvanig



studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	administron regjistrat e posaçëm. Të dhënat e disponuara përditësohen dhe përpunohen, sipas proceve instrucionale dhe raportimeve të ndryshme. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 4 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon: 2020-2021 105 studentë; 2021-2022 84 studentë; 2022-2023 91 studentë; 2023-2024 64 studentë; Evidenca nr. 48 Statistika mbi numrin e studentëve të diplomuar MSC DP; Evidenca nr. 2 Rregullore e organizimit UMSH;
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ vëren se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes në dy forma. Në formatin hard copy dhe resgjistrave respektivë si dhe në format elektronik, përmes sistemit të menaxhimit të informacionit SMS. Të dhënat i nënshtohen legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tyre. Gjithashtu saktësia e të dhënave mundëson verifikimin e tyre në çdo kohë nga persona të autorizuar. Evidenca nr. 40 Manual për përdorimin e SMS-së; Evidenca nr. 2 Rregullore e organizimit UMSH;
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me	Bazuar në aktet e brendshme, institucioni mbështet kontrollin periodik të njësive. Ndërkohë institucioni nuk ka paraqitur një raport të mënyrës sesi vlerësohet dokumentimi i gjendjes dhe saktësisë së informacionit. i vetmi vlerësim periodic është ai i realizuar nga NJSBCZHK për vlerësimin e shërbimeve në institucion. Evidenca nr. 2 Rregullore e organizimit UMSH; Evidenca nr.16 Rregullore e NJSBCZHK;

Handwritten signature

Handwritten signature

veprimtarinë e tyre përkatëse.					
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ vlerëson se njësia bazë, në analizën vjetore në saj, duhet të hartojë dhe paraqesë raporte periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Sot kjo procedurë realizohet nga sekretaria mësimore. Gjithashtu me të dhënat mbi cilësinë e punësimit të studentëve të diplomuar, është angazhuar Zyra e Alumni. Evidenca nr. 2 Rregullore e organizimit UMSH; Lista e aktiviteteve ALUMNI;				
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, vë në dispozicion struktura të posaçme për mbledhjen, përditësimin dhe ruatjen e të dhënave në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, diplomuar, transferuar çregjistruar etj. Gjithashtu institucioni ruan të dhëna dhe kontakte, madje dhe organizon aktivitete me të diplomuarit e tij, të cilët shërbejnë dhe si promotor dhe nxitës së punësimit për studentët aktualë. Sekretaria mësimore ruan dhe administron regjistrat e posaçëm dhe gjithashtu ruan të dhëna të format elektronik</i> <i>Megjithatë, njësia bazë duhet të ketë pjesë të raportit vjetor të veprimtarisë së saj të dhëna mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, të cilat e asistojnë për të marrë masat e duhura për përmirësimin e programit dhe punësimit të studentëve.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table> <tr> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X	
Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
X					

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe	GVJ vlerëson se institucioni ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve apo përfaqësueve të tyre në organet

angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	vendimmarrëse apo këshilluese. Sipas nenit 11 të Rregullores së organizimit, në Senatin Akademik përfaqësohen edhe studentët në masën 10%. Gjithashtu studentët kanë përfaqësues në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë si dhe janë të organizuar në Këshillin Studentor. Evidenca nr.2 Rregullore e Organizimit UMSH; Ngritja dhe rregullorja e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Cilësisë dhe Standardeve;
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se garantimi i përfshirjes së studentëve realizohet përmes parashikimit të dedikuar në aktet e brendshme të institucionit. Edhe pjesëmarrja e studentit në procesin e vetëvlerësimit të brendshëm mundëson angazhimin e tyre drejtë sigurimit të standardeve të cilësisë. Studentët në mënyrë të tërthortë, përmes shpres së mendimit të tyre periodik në pyetësorët e studentëve, përfshihen në vlerësimin e procesit akademik. Studentët janë të organizuara në struktura të pavarura, në formën e Këshillit Studentor. Evidenca nr. 1 Statuti UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e organizimit UMSH; Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Evidenca nr. 34 Rregullore e Këshillit studentor;
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Në takimin me studnetët, GVJ konstatoi se studentët përfshihen në rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit, nëpërmjet shprehje së mendimit të tyre, në formualrët e vlerësimit të lëndëve apo përmes instrumentave të ndryshëm të ofruar nga NJSBCZHK. Gjithashtu, studentët përfaqësues në Senatin Akademik shprehin darkordësinë e tyre në rastin e miratimit të programeve të reja apo riorganizimit të atyre ekzistuese. Studentët e programit të studimit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e hapura të Departamentit ose shprehin mendimet e tyre përmes Këshillit Studentor. Pamvarësisht praktikave të mira të ndjekura, <u>GVJ rekomandon</u> angazhimin e studentëve ne procesin e rishikimit të programit. Ky angazhim të realizohet përmes pjesëmarrjes periodike në mbledhjet e njësisë bazë apo kryesore si dhe duke iu mundësuar

	studentëve të shprehin mendimet dhe sygjërimet e tyre, edhe në emër të studentëve që përfaqësojnë. Evidenca nr. 1 Statuti UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e organizimit UMSH; Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Evidenca nr. 34 Rregullore e Këshillit studentor;		
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ vëren senë rregulloret e posaçme studentëve u mundësohet ankimimi i rezultatit dhe rishikimi i tij. Studenti ka të drejtë të njihet paraprakisht me vlerësimin nga ana e komisionit të provimit, përpara se të regjistrohet, rezultati përfundimtar nga sekretaria mësimore. Pas daljes së rezultatit, student që nuk është dakord me vlerësimin, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit. Dekani pasi vlerëson ankesën ngre një komision i cili bën rivlerësimin e tezës së provimit ose e rimerr studentin në provim. Evidenca nr. 6 Rregullor e FDSHH; Evidenca nr. 20 Udhëzuesi i studentëve;		
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse, bazuar në aktet nëligjore të brendshme. Gjithashtu institucioni merr pjesë vetëm në vlerësimin e programit të studimit, përmes zhvillimit të pyetësorëve vlerësues. Ndërkohë është e nevojshme dhe angazhimi i studentëve në procesin e rishikimit të programit, nëpërmjet pjesëmarrjes periodike në mbledhjet e njësisë bazë apo kryesore, duke shprehur dhe mendimet e konsideratat e grupit të studentëve që përfaqësojnë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6

Procurat



Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstaton se institucioni ka njësi e procedura të posaçme në shërbim të informimit të studentëve. Këto procedura dhe njësi përshkruhen në aktet e brendshme të institucionit. Gjithashtu institucioni harton, miraton dhe publikon udhëzime, procedura dhe broshura informuese. Informimi nuk konsiston vetëm mbi programin e studimit, por dhe informacin lidhur me organizimin dhe funksionimin e institucionit dhe njësive përbërëse të tij. Informacioni aksesohet online ose përmes zyrave respektive. Evidenca nr.2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 20 Udhëzuesi I Studentit; Evidenca nr. 33 Broshura e programit SSCDP; Evidenca nr. 49 Të dhëna nga faqja zyrtare e UMSH-së;
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ vlerëson se institucioni ka bashkërenduar procesin e informimit elektronik me atë të ngritjes së zyrave të dedikuara të cilat merren me informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimi të studentëve. Këtu struktura mbështeten edhe nga Këshilli Studentor, i cili mundëson informim dhe mbështetje të vazhdueshme, veçanrisht për studentët e rinj. Evidenca nr.2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 35 Rregullore e ZKSK; Evidenca nr. 34 Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor; Evidenca nr. 40 Manual për përdorimin e SMS-së;
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të	Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, ofron mbështetje për studentët për organizimin dhe mbarëvajtjen e këshillimit akademik në funksion të tyre, për të sqaruar çdo paqartësi dhe për trajtuar vështirësitë me të cilat ai haset. Gjithashtu zyra mbështet studentët në vështirësitë akademike dhe kapërcimin e pengesave për arritjen e rezultateve më të mira. Një aspekt shumë i rëndësishëm është edhe këshillimi që u ofrohet


posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	studentëve që diplomohen në ciklin e parë, për mundësitë e vijimit të studimeve të ciklit të dytë. Nëpërmjet realizimit të objektivave, mundësohet nxitja e frymës së bashkëpunimit mes institucionit dhe studentëve apo ish studentëve, për të promovuar institucionin dhe praktikën më të mira që ofron. Evidenca nr. 35 Rregullore e ZKSK; Plani vjetor i punës 2022-2023 dhe 2023-2024 i Zyrës për Këshillimin e Karrierës;
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në bashkëpunim me strukturave të këshillimit të karrierës dhe ALUMNI mundësohet sipas GVJ, që të mbledhen përpunohen dhe të mbahen të dhëna me studentët e diplomuar. Kjo mundëson dhe realizimin e takimeve dhe organizimeve të ndryshme në institucion me studentët ALUMNI, si një formë e ruajtjes së lidhjeve cilësore të nevojshme dhe shpërndarjen e shembujve pozitivë e të suksesshëm për studentët e rinj. Të dhënat e grumbulluara në formën e statistikave u vihen në dispozicion organeve drejtuese përkatëse, për zhvillimin e politikave institucionale dhe për arsye promovimi. Evidenca nr. 35 Rregullore e ZKSK; Plani vjetor i punës 2022-2023 dhe 2023-2024 i Zyrës për Këshillimin e Karrierës; Evidenca nr. 35 Rregullore e ZKSK; Evidenca nr. 41 Raporti i ALUMNI; Lista e aktiviteteve ALUMNI;
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, ka procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin dhe këshillimin në karrierë të studentëve. Institucioni mundëson një proces të menaxhimit të ankimeve dhe problematikave të studentët, duke bashkërenduar procesin me sekretarisë mësimore të fakultetit dhe dekanit.</i> <i>Procesi i informimit është elektornik por edhe pranë zyrave të posaçme të ngitura e të vëna në dispozicion të studentëve.</i> <i>Insitucioni ruan një databazë të studentëve të diplomuar dhe punësuar, duke përpunuar të dhëna e ofruara në kuadër të cilësisë së programit të studimit të ofruar. Gjithashtu organizon</i>

	takime me ALUMNI për të ndarë praktikat më të mira dhe për të shërbyer si forma promovimi institucional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstaton se hartimi i udhëzuesve në nivel institucional është në formën e manualeve për përdorimin e platformave të ndryshme, që asistojnë procesin mësimor. <u>Ndërkohë që strukturat nuk kanë paraqitur udhëzues të dedikuar për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve.</u> Leksionet e hapura dhe profesorë të ndryshëm të ftuar, të cilët vinë në institucion realizojnë prezantimin dhe zhvillimin e personelit në këtë aspekt. Evidenca nr. 15 Leksione të hapura në DD; Evidenca nr. 32 Manuali i përdorimit të platformave online;
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit	GVJ vlerëson se institucioni ka ngritur një strukturë të dedikuar për zhvillimin e mekanizmave të vlerësimit periodik të aftësive të mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, përmes pyetësorëve periodikë dhe fokus grupeve, analizon strukturën, cilësinë dhe ngritjen akademike të stafit, duke përfshirë të gjithë elementët e procesit mësimor (referuar nenit 2 të rregullores së NJSBCZHK). Në

Procuri


akademik dhe ndihmësakademik.	bashkëpunim me strukturat Brenda institucionit, njësia propozon dhe ndjek një plan kalendarik të vlerësimit semestral, sipas të cilit monitorohet procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rezultatet e vlerësimit janë pjesë e dosjes personale të personelit akademik, pranë zyrës së Burimeve Njerëzore. Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK; Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Evidenca nr. 29. Plani i monitorimit DD; Evidenca nr. 31 Procedura me fokus grupet; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH;
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi se studentët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit të institucionit, duke qenë pjesë e grupeve të ndryshme të punës, brenda Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave. Sipas nenit 6 të rregullores së NJSBCZHK, atyre mund ti besohen punë dhe çështje të caktuara specifike siç janë vlerësimi i programeve të ndryshme studimore, kontrolli i burimeve dhe financave, trajnimi i stafit dhe ngritja e tyre, shërbimet e studentëve, bashkëpunimi i jashtëm etj. Studentët janë të përfshirë në procesin e vetëvlerësimit të programit të studimit, duke dhënë mendimin dhe kontributin e tyre sa herë i kërkohet. <u>GVJ rekomandon</u> të rishikohet roli i studentëve në përfshirjen për vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. Përfshirja e studentëve duhet të jetë e garantuar në aktet e brendshme të institucionit. Ndërkohë studentët mund të ndërmarrin vetë iniciativa apo të bëjnë kërkesa dhe propozimenë lidhje me instrumentat, metodat për matjen e performancës Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK; Evidenca nr. 31 Procedura me fokus grupet;
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në	GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Vlerësimet dhe matja e performancës kryhet në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të

mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	dhëname. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive. Në rastin e personelit akademik, vlerësimi i tyre është pjesë e dosjes së personelit pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. Njohja me raportet e vlerësimit bëhet përmes publikimit por edhe përmes prezantimit të gjetjeve në takime të njësive, me këshillin studentore. Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK; Evidenca nr. 46 Formulari i vetëvlerësimit; Evidenca nr. 49 Të dhëna nga faqja zyrtare e UMSH;
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ vlerëson se në UMSH, përmes mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovohen shembuj të praktikave më të mira dhe personeli akademik nxitet për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Edhe pse nuk është paraqitur një dokument i posaçëm, kjo rezultoi gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, ku personelet pohuan se zhvillohen në mënyrë periodike takime në njësi për analizimin e rezultateve të nxjerra nga vlerësimi. Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Evidenca nr. 29. Plani i monitorimit DD;
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo realizohet përmes ngritjes dhe funksionimit të një njësie të dedikuar, përgjegjëse për vlerësimin periodik dhe matjes së performancës. Njësia gjeneron formatet e vlerësimit përmes pyetësorëve dhe harton raportet respektive që i vihen në dispozicion strukturave drejtuese dhe personeleve, si pjesë e dosjes së tyre. Njësia bashkëpunon dhe me njësitë e tjera në institucion për mbarëvajtjen e procesit. Rezultatet bëhen publike si dhe janë objekt diskutimi në mbledhjet e njësive.</i> <i>Duhet të rishikohet roli i studentëve në pjesëmarrjen dhe në proceset e vlerësimit periodik të mësimdhënies dhe matjes së performancës.</i>

Konkluzione



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ vlerëson se institucioni ka politika, struktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo politikë reflektohet në aktet e brendshme të institucionit dhe më pas zbërthehet në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve respektive, për ti ardhur në ndihmë personeleve dhe studentëve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Vlerësimet dhe matja e performancës kryhet në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive. Në rastin e personelit akadmeik, vlerësimi i tyre është pjesë e dosjes së personelit pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. Evidenca nr. 1 Statuti i UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK;
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe	GVJ konstaton se ngritja dhe funksionimi i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave është në përputhje me planin strategjik të zhvillimit UMSH dhe strategjinë e zhvillimit të programit të studimit MSCDP. Pjesë e strategjisë së zhvillimit është edhe kontributi aktiv që studentët japin përmes pyetësorëve, duke ofruar mundësitë e evidentimit dhe zhvillimin e mekanizmave vetëpërmirësues të cilësisë.

bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Evidenca nr. 4 Plani strategjik i zhvillimit UMSH; Evidenca nr. 5 Strategjia e zhvillimit të programit MSC e drejtë publike; Evidenca nr. 1 Statuti i UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK;
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ vlerëson se institucioni ka politika, struktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo politikë reflektohet në aktet e brendshme të institucionit dhe më pas zbërthehet në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve respektive, për ti ardhur në ndihmë personeleve dhe studentëve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Vlerësimet dhe matja e performancës kryhet në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive. Procesi i vlerësimit të jashtëm kryhet përmes procesit të akreditimit dhe vlerësimit të jashtëm të institucionit dhe programeve të studimit. Evidenca nr. 1 Statuti I UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK;
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ vlerëson se në institucion përdoren tregues të qartë e të matshëm të mësimdhënies dhe këkrimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave realizon vlerësimet dhe matjen performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive. Njësia është përgjegjëse për hartimin e modelit të institutentave që përdoren. Evidenca nr. 1 Statuti I UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK;

Handwritten signatures and stamps.

	Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Evidenca nr. 29. Plani i monitorimit DD; Evidenca nr. 28 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese;			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, zbaton politika dhe procedura transparente për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Përmes ngritjes së strukturave të dedikuara realizohet mbarëvajtja e procesit, mbledhja, përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Institucioni përdor instrumenta dhe tregues për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për	GVJ gjatë takimeve të zhvilluar akonstaton se programet e studimit janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre. Indikatorët për përmirësimin merren nga njohja me rezultatet e vlerësimit, që gjenerohen nga pyetësorët e studentëve. Drejtuesit e njësive marrin pjesë dhe monitorojnë zhvillimin e lëndëve në programin e studimit si dhe ndihmojnë në nxitjen e kërkimit shkencor dhe motivimit për personelet. Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK; Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Evidenca nr. 29. Plani i monitorimit DD;

përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Evidenca nr. 28 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese;
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave realizon vlerësimet dhe matjen performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive në dosjet e personelit pranë Zyrës së Burimeve Njërëzore. Instrumentave të cilësisë periodike, u bashkëlidhen dhe vlerësimi i marrë nga procedurat e realizuara me fokus grupe. Informacioni i gjeneruar nga instrumentat e vlerësimit, përdoret në fund të çdo viti akademik nga ana e strukturave përgjegjëse, para firmosjes së kontratave me afat të caktuar. Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK; Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Evidenca nr. 29. Plani i monitorimit DD; Evidenca nr. 28 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese; Evidenca nr. 31 Procedura me fokus grupet;
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të	GVJ pas takimeve të zhvilluara në institucion vlerëson së metodat e përdorura në kuadër të vlerësimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit janë gjithë përshirëse në disa nivele dhe njësi. Ato mund të organizohen në formën e seancave dëgjimore apo vëzhgimi në një orë mësimi në auditor. Në formën e minitorimit të korrigjimit të provimeve, monitorimi i realizuar gjatë hartimit të silabuseve. Ndërkohë paralelisht realizohet përmes instrumentave të pyetësorëve, sondazheve dhe pyetësorëve me fokus grupe. Kjo metodologji lejon gjithëpërfshitjen e vlerësimit në disa nivele, duke rritur transparencën dhe mundësuar një vlerësim objektiv.

Handwritten signatures and notes in blue ink.

studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Evidenca nr. 1 Statuti I UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK; Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Evidenca nr. 29. Plani i monitorimit DD; Evidenca nr. 28 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese; Evidenca nr. 31 Procedura me fokus grupet;
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave realizon vlerësimet dhe matjen performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive. Këto raporte publikohen dhe shpesh janë objekt i mbledhjeve të njësive apo takimeve të tjera të realizuara në institucion, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për sigurimin e standardeve të cilësisë. Gjithashtu studentët kontribuojnë jo vetëm në vlerësimin e procesit të mësimdhënies e mësimnxënies, por edhe në vlerësimin e strukturave administrative, shërbimeve dhe kapaciteteve. Praktikë e mirë është edhe përfshitja e studnetëve të diplomuar, në vlerësim, përmes pyetësorëve apo takimeve të zhvilluara në institucion. Evidenca nr. 1 Statuti I UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK; Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët; Evidenca nr. 29. Plani i monitorimit DD; Evidenca nr. 28 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese; Evidenca nr. 31 Procedura me fokus grupet; Evidenca nr. 41 Raporti ALUMNI;

Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, monitoron dhe vlerëson përmes njësisë së dedikuar për sigurimin e cilësisë, programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese. Vlerësimi kryhet përmes monitorimit dhe vlerësimit periodik i cili mbidhet përmes instrumentave të pyetësorëve dhe organizimit në fokus grupe. Edhe studentët e diplomuar përfshihen në vlerësimin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vlerëson se institucioni parashikon dhe garanton politika e procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në aktet e tij të brendshme rregulluese. Sigurimi i brendshëm i cilësisë garantohet nga njësia përgjegjëse, realizon vlerësimet dhe matjen performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave dhe hartimin e raporteve respektive. Pjesë e vlerësimit të jashtëm është procesi periodik i akreditimit dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me ASCAL. Evidenca nr. 1 Statuti I UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK;
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të	GVJ vë re se në Rregulloren e NJSBCZHK janë përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, studentët dhe palët e angazhuara në procesin e vlerësimit të brendshëm. Kjo realizohet përmes dinamizmit dhe përfaqësimit të përbërjes së njësive por edhe bashkëpunimit që ka me njësitë dhe strukturat e tjera brenda institucionit.

Muric

[Signature]

studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Evidenca nr. 1 Statuti I UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK;
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave realizon vlerësimet dhe matjen performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave të kategorizuara sipas njësive kryesore dhe njësive bazë. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive për tu njohur dhe për të nxitur politika përmirësuese në të ardhmen. Instrumentat e përdorur nuk fokusohen vetëm në vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies por edhe në vlerësimin e njësive administrative, infrastrukturës, kapaciteve, mështetjes etj. Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e JSBCZHK;
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ vëren se në proceset ciklike të vlerësimit përfshihen dhe aktivizohen personele dhe student të cilët respektojnë integritetin akademik. Këto procese përfshijnë qoftë vlerësimin periodik si anëtarë të grupeve të punës ad hoc që ndrihen nga NJSBCZHK por gjithashtu dhe për grupet e punës që ngrihen me synim realizimin e procesit të vetëvlerësimit të programit të studimit. Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK;
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje	Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm, e japin kontributin e tyre në mënyrë aktive po indirekte, përse i përket proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Leksionet e hapurta dhe aktivitetet shekncore, janë pjesë e kontributit që jepet në këtë aspekt. Gjithashtu për këtë program studimi janë mundësuar edhe vizita apo shkëmbime me institucionet partnere, duke evidencuar praktikatat më të mira. Evidenca nr. 15 Leksione të hapura DD;

Handwritten signature

Handwritten signature

me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Evidenca nr. 38 Aktivitetet shkencore të UMSH; Planifikimi i vizitës studimore në Kosovë;			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, përfshin njësitë akadmeike, personelin akadmeik dhe studentët në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke kontribuar në këtë formë aktivisht për arritjen e rezultateve më të ëmira dhe për marrjen e masave në vijim. Vlerësimi kryhet përmes përdorimit të instrumentave të ndryshëm të vlerësimit dhe rezultatet publikon dhe diskutohen.</i> <i>Angazhimi i ekspertëve të jashtëm dhe bashkëpunëtorëve realizohet në formën e leksioneve të hapura ose aktiviteteve të ndryshme shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave realizon vlerësimet dhe matjen performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave të kategorizuara sipas njësive kryesore dhe njësive bazë. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personeleve respektive për tu njohur dhe për të nxitur plotika përmirësuese në të ardhmen. Evidenca nr. 1 Statuti I UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK; Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët Evidenca nr. 29. Plani i monitorimit DD;

	Evidenca nr. 28 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese; Evidenca nr. 31 Procedura me fokus grupet;
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ vlerëson se në rregulloren e NJSBCZHK janë parashikuar mënyrat e publikimit të rezultateve të vlerësimit dhe garantimin e parimit të lirisë dhe etikës akademike. Për zhvillimin e pyetësorëve respektohet parimi i anonimatit dhe rekomandimet dhe sygjërimet e dhëna nuk çenojnë parimin e autonomisë akademike. Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK;
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, konstaton se raportet e vlerësimit kanë si synim jo vetëm evidentimin e gjendjes aktuale të cilësisë në institucion, por edhe të mënyrës së ndërhyrjes dhe marrjeve të masave, sipas të dhënave të përpunuara. Edhe pse nuk është paraqitur një dokument për marrjen e një mase konkrete, të dalë nga këto vlerësime, gjatë takimeve në institucion studentët përmendën adresimin e nevojës së shkëmbimit të në kuadër të programit Erasmus + për programin e tyre të studimit apo zhvillimit të vizitave studimore në vendet e rajonit. Të dyja këto kërkesa janë shqyrtuar nga organet drejtuese dhe janë marrë masat respektive. Gjithashtu një praktikë për tu vlerësuar, është kërkesa e studentëve për të patur sa më shumë aktivitete praktik dhe institucioni është angazhuar në intensifikimin e punës për Klinikën Ligjore. Planifikimi i vizitës studimore në Kosovë; Plani vjetor i punës për 2023-2024 i Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë, Erasmus+ dhe Projekte; Plani vjetor i punës 2022-2023 dhe 2023-2024 Klinika Ligjore;
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vëren se institucioni përmes NJSBCZHK realizon vlerësimet dhe matjen performancës, në mënyrë periodike dhe më pas realizohet përpunimi dhe analizimi i të dhënave. Raportet e vlerësimit periodik të cilësisë u vihen në dispozicion strukturave drejtuese por edhe personave respektive. Këto raporte publikohen dhe shpesh janë objekt i mbledhjeve të njësive apo takimeve të tjera të realizuara në institucion, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për sigurimin e standardeve të cilësisë. Gjithashtu studentët kontribuojnë jo vetëm në vlerësimin

	e procesit të mësimdhënies e mësimnxënies, por edhe në vlerësimin e strukturave administrative, shërbimeve dhe kapaciteteve. Praktikë e mirë është edhe përfshitja e studentëve të diplomuar, në vlerësim, përmes pyetësorëve apo takimeve të zhvilluara në institucion. Evidenca nr. 1 Statuti I UMSH; Evidenca nr. 2 Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca nr. 16 Rregullore e NJSBCZHK; Evidenca nr. 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët Evidenca nr. 29. Plani i monitorimit DD; Evidenca nr. 28 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoritet drejtuese; Evidenca nr. 31 Procedura me fokus grupet; Evidenca nr. 41 Raporti ALUMNI;
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni garanton veprimtari periodike me personelin dhe studentët, me synim jo vetëm informimin për organizimin dhe funksionimin e institucionit në të gjitha njësitë përbërëse të tij, por dhe synon rritjen e ndërgjegjësimin për rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në institucion. Për këtë arsye në mënyrë periodike organizohen aktivitete trajnuese dhe ndërgjegjëse, gjithëpërfshirëse, ku tematikat e trajnimit herë lidhen në mënyrë direkte e herë në mënyrë jo direkte me sigurimin e cilësisë së programeve të studimit dhe sigurimin e cilësisë në institucion. Evidenca nr. 25 Programi i trajnimeve;
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion ka konstatuar se UMSH, politikat, proceset dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë publike transparente dhe efektive. Politikat zërthehen në aktet e brendshme të institucionit por edhe në strategjinë apo planin e zhvillimit të tij.</i> <i>Për çdo raport vlerësimi, sipas gjetjeve respektive duhet të publikohet edhe plani i masave të nevojshme për tu ndërmarrë. Institucioni organizon veprimtari trajnuese dhe ndërgjegjëse</i>

	<i>për rëndësinë dhe efikasitetin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në: “E drejtë Publike”

a. Pikat e forta:

1. Departamenti i së Drejtës ka efektiv klinikën e ligjit dhe në bazë të një procedure të paracaktuar përzgjedh studentët për t'u trajnuar në të. Gjithashtu u konstatua se Departamenti i së Drejtës zhvillon në mënyrë periodike konferenca shkencore me pjesëmarrjen e studentëve, mentoruar nga pedagogët e këtij departamenti;
2. Njësia bazë ka rritur përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor nëpërmjet realizimit të konferencave shkencore, përbashkëta me pedagogët e këtij universiteti, vizitave studimore në vende të tjera dhe në projektet Erasmus+;
3. Institucioni nxit studentët të marrin pjesë në aktivitete shkencore të përbashkëta me stafin akademik dhe mbështet financiarisht kërkimin shkencor, zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kërkimore shkencore duke evituar pengesat burokratike dhe duke respektuar një procedurë standard;
4. Në përgjithësi fusha e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhet me lëndët që mbulojnë dhe se kanë shkallën e kërkuar të kualifikimit për të mbuluar zhvillimin cilësor të mësimin në ciklin e studimeve Master i Shkencave në “E Drejtë Publike”;
5. Departamenti i së Drejtës, ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, hartimin dhe realizimin e projekteve dhe konferencave shkencore në bashkëpunim me studentët apo vizita studimore. Projektet dhe kërkimi shkencor stimulohet edhe nga mbështetja financiare që institucioni ofron për punën shkencore të stafit të tij akademik dhe të studentëve;
6. Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar të planifikimit dhe përdorimit të burimeve financiare dhe ka ngritur një strukturë të posaçme dedikuar auditimit, strukturë e cila është përgjegjëse për kontrollin dhe auditimin e brendshëm;

Araceli



7. Institucioni ofron mundësi të pajisjes së studentëve me bursa apo reduktim të tarifave dhe ofron lehtësira për studentët me aftësi ndryshe. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës drejton dhe mbështet studentët gjatë procesit të formimit dhe i orientojnë e këshillojnë ata me kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjeve;
8. Institucioni në mënyrë periodike organizon aktivitete trajnuese, ndërgjegjësuëse dhe gjithëpërfshirëse, ku tematikat e trajnimit lidhen ndër të tjera dhe me sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në institucion;

b. Pika të dobëta:

1. Moszbatim efektiv i marrëveshjeve të bashkëpunimit, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit; *(Standarti I.3, kriteri 2)*
2. Mospërditësim i syllabuseve, si emërtimi, përmbajtja e lëndëve etj, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, lidhur me *evoluimin e së drejtës në këtë fushë*, të cilat nuk mundësojnë thellim të njohurive në këtë fushë; *(Standarti II.4, kriteri 1, 5)*
3. Literatura bazë dhe e rekomanduar në programet e lëndëve, rezulton e papërditësuar, nuk i përkasin botimeve të viteve të fundit; *(Standarti IV.3, kriteri 1)*

Rekomandime

1. Institucioni duhet të punojë për zbatimin efektiv të marrëveshjeve të bashkëpunimit, dhe të rrisë bashkëpunimin me organet e reja të drejtësisë që lindën si pasojë e reformës në Drejtësi dhe me institucione të tjera të rëndësishme që operojnë në fushën e së drejtës, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë jo vetëm në zhvillimin e praktikave mësimore për studentët, por edhe për evidentimin e nevojave konkrete të këtyre institucione që mund të përkthehen në përmirësim të kurrikulave mësimore të ofruara në masterin shkencor “E Drejtë Publike”;
2. GVJ rekomandon rishikimin dhe përmirësimin e emërtimeve dhe të përmbajtjes së lëndës me qëllim dallimin në mënyrë të përshtatshme të lëndëve që zhvillohen me ciklin e mëparshëm të studimit dhe thellimit të tyre në këtë cikël studimi, të përditësohen syllabuset me evoluimin bashkëkohor të së drejtës, duke e pasuruar me praktikën gjyqësore, rifreskuar tekstet mësimore;
3. GVJ rekomandon që fondi i bibliotekës të pasurohet me literaturë kombëtare dhe ndërkombëtare që i përgjigjet 5 viteve të fundit, në përputhshmëri me kërkesat ligjore;
4. Rekomandohet përkthimi i syllabuseve në anglisht si një domosdoshmëri jo vetëm në kuadër të ndërkombëtarizimit por dhe për përthithjen e studentëve të huaj në kuadër të shkëmbimit Erasmus;
5. Departamenti i së Drejtës të rrisë ndërveprimin me fakultetet dhe departamentet e tjera të UMSH, me qëllim përgatitjen ndërdisiplinore të studentëve të tij, që të mund të adresohen në mënyrë më të përshtatshme në sfidat e punësimit, që gjithnjë e më shumë janë të orientuara drejt profesionistëve me përgatitje ndërdisiplinare;

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle Master of Science study program in:
"Public Right"**

a. Strength points:

1. The Department of Law has an effective law clinic and, based on a predetermined procedure, selects students to be trained in it. It was also established that the Department of Law periodically holds scientific conferences with the participation of students, mentored by the lecturers of this department;
2. The Department has increased the involvement of students in scientific research through the realization of scientific conferences, shared with the lecturers of this university, study visits to other countries and Erasmus+ projects;
3. The institution encourages students to participate in joint scientific activities with the academic staff and financially supports their scientific research, the development of various scientific research activities by avoiding bureaucratic obstacles and respecting a standard procedure;
4. In general, the field of qualification of the academic staff engaged in this study program matches the subjects they cover. Also the academic staff has the required degree of qualification to cover the quality development of the teaching in the Master of Science in "Public Law" study cycle;
5. The Department of Law has a suitable climate for the development of innovative and research ideas, the design and implementation of scientific projects and conferences in collaboration with students or study visits. Projects and scientific research are also stimulated by the financial support that the institution provides for the scientific work of its academic staff and students;
6. The institution has a well-defined procedure for planning and using financial resources and has set up a specific structure dedicated to auditing, which is responsible for internal control and auditing;
7. The institution offers opportunities to equip students with scholarships or reduced fees and provides facilities for differently abled students. The Student and Career Counseling Office directs and supports students during the training process and guides and advises them with the demands of the labor market and options;
8. The institution periodically organizes training, awareness-raising and comprehensive activities, where the training topics are related, among other things, to ensuring the quality of study programs in the institution;


b. Weak points:



1. Effective non-implementation of cooperation agreements, which directly affect the improvement of the curriculum of the study program; (*Standard I.3, criterion 2*);
2. Lack in updating the syllabuses, such as the title, the content of the subjects, etc., in accordance with the effective needs of the Market Employment, which do not enable deepening of knowledge in the public field in accordance to the latest evolution of law in this area; (*Standard II.4, criteria 1, 5*);
3. The basic and recommended literature in the course programs is not updated; they lack the publications of recent years; (*Standard IV.3, criterion 1*)

Recommendations

1. The institution shall improve the work for a better implementation of the cooperation agreements and increase cooperation with the new bodies of justice that arose as a result of the reform in the Law and with other important institutions operating in the field of public law. This will influence directly not only in the improvement of teaching practices for students, but also will serve to identify the concrete needs of these institutions that can be translated into the improvement of the teaching curricula offered in the scientific master's degree "Public Law";
2. "GVJ" recommends reviewing and improving the titles and content of the syllabuses in order to appropriately distinguish the courses developed in the previous cycle of study and to deepen them in this cycle of study, to update them with the contemporary evolution of law, enriched with judicial practice, updated textbooks;
3. "GVJ" recommends that the library fund shall be enriched with national and international literature that corresponds to the last 5 years, in compliance with legal requirements;
4. The translation of syllabuses into English is recommended as a requirement not only in the context of internationalization but also for the captivation of foreign students in the context of the Erasmus exchange;
5. In order to increase interaction with other faculties and departments of UMSH, The Department of Law shall improve the interdisciplinary courses for its students, so that they can more appropriately address the challenges of employment, which are increasingly oriented towards professionals with interdisciplinary preparation;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X